



**REPUBLIKA SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
DEPARTAMENTI I LENDEVE PARAKLINKE**



---

Adresa: Rr. e Dibrës, brënda QSU “Nënë Tereza”, Tiranë. Tel.&Fax: 2362 619; Tel. 2373835;

## **DISERTACION**

Për Marrjen e Gradës Shkencore

**DOKTOR**

**VLERËSIMI I SJELLJEVE TË RREZIKSHME TË LIDHURA ME  
HIV/AIDS DHE PROBLEME TË SHËNDETIT SEKSUAL TË  
PËRDORUESIT E DROGAVE ME INJEKTIM, MESHKUJ QË  
KRYEJNË SEKS ME MESHKUJ DHE POPULLATA ROME**

**UDHËHEQËS SHKENCOR: PROF. ASC. DR. ALBANA FICO**

**Kandidati: Roland Bani**



**REPUBLIKA SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
DEPARTAMENTI I LËNDËVE PARAKLINKE**



Adresa: Rr. e Dibrës, brënda QSU “Nënë Tereza”, Tiranë. Tel.&Fax: 2362 619; Tel. 2373835;

## **DISERTACION**

Për Marrjen e Gradës Shkencore

### **DOKTOR**

# **VLERËSIMI I SJELLJEVE TË RREZIKSHME TË LIDHURA ME HIV/AIDS DHE PROBLEME TË SHËNDETIT SEKSUAL TË PËRDORUESIT E DROGAVE ME INJEKTIM, MESHKUJ QË KRYEJNË SEKS ME MESHKUJ DHE POPULLATA ROME**

**UDHËHEQËS SHKENCOR: PROF. ASC. DR. ALBANA FICO**

**Kandidati: Roland Bani**

MBROHET MË DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ PARA JURISË

- |                              |                   |
|------------------------------|-------------------|
| 1. Prof.Asc. Gerntian STRONI | KRYETAR           |
| 2. Prof.Asc. Ergys RAMOSAÇO  | ANËTAR ( Oponent) |
| 3. Prof.Asc. Dritan ULQINAKU | ANËTAR ( Oponent) |
| 4. Prof.Dr. Shpëtim QYRA     | ANËTAR            |
| 5. Prof.Dr. Eduard KAKARRIQI | ANËTAR            |

## **Parathënie**

*Për të adresuar një problem të shëndetit publik, së pari duhet që të jetë i disponueshëm informacioni i nevojshëm dhe i saktë. Studimet eurvejancës biologjike dhe të sjelljes kanë rezultuar të jenë mjete të paçmueshme për matjen dhe adresimin e problemeve të lidhura me infeksionin HIV, që mbetet një nga sfidat më të mëdha në botë e shëndetit publik. Fokusi kryesor është te popullatat kyç, të cilat shpesh janë të fshehura dhe të vështira për arritur si pjesë e studimeve të bazuara në popullatën e përgjithshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse popullatat kyç janë në rrezik të lartë për marrjen e infeksionit HIV dhe mungesën e aksesit në shërbimet e trajtimit, parandalimit për HIV, si dhe në shërbime të tjera shëndetësore.*

*Njohja e prevalencës së infeksionit HIV, faktorëve të rrezikut dhe i mbulimit me shërbimet te parandalimit dhe trajtimit janë thelbësore për të luftuar epideminë e HIV-it. Kështu, studimet eurvejancës biologjike dhe të sjelljes (SSBS) që vlerësojnë këto parametra janë komponentë integralë të një strategjie kombëtare dhe të sistemit tëurvejancës për HIV. Shumë individë me rrezik të lartë për HIV janë të marginalizuar nga shoqëria dhe mund të mos e identifikojnë veten si të tillë kur marrin shërbime. Kjo e bën të vështirë gjurmimin e tyre dhe pengon përpjekjet për të vlerësuar efektivitetin e shërbimeve.*

*Ky punim përfaqëson një përpjekje serioze për sigurimin e një infomacioni ka për për qëllim njohjen dhe të kuptuarit më mirë të kontekstit social dhe epidemiologjik të sjelljeve të rrezikshme të lidhura me infeksionin HIV të popullatave kyç dhe rrjetit të tyre shoqëror. Ky informacion do të shërbejë si një udhëzues për politikëbërësit dhe drejtuesit e programeve në hartimin e politikave strategjike dhe programeve parandaluese të përshtatshme.*

*Mbledhja e të dhënave në mënyrë sistematike nga këto popullata, Përdoruesit e Drogave me Injektiv (PDI), Meshkujt që kryejnë Seks me Meshkuj (MSM), dhe nga Popullata Rome, do të bëjë të mundur sigurimin e një informacioni që do të kontribuojë për monitorimin e ndryshimit të prevalencës dhe sjelljeve në kohë. Gjithashtu, ky studim synon të kontribuojë në përmirësimin eurvejancës së sjelljeve të rrezikshme dhe infeksioneve të lidhura me to si një pjesë e rëndësishme e Planit Kombëtar të Monitorim-Vlerësimit të HIV/AIDS.*

## **Falenderime**

Realizimi i këtij punimi ka qenë një rrugëtim i gjatë e i vështirë, pjesë e të cilit janë bërë shumë miq e kolegë, që më kanë mbështetur dhe më kanë shtyrë drejt finales. Një falenderim i veçantë për udhëheqësen Prof. Asc. Dr. Albana Fico. Në sajë të karakterit të saj këmbëngulës shumëçka e pamundur u bë e mundur. Ne së bashku arritëm dhe bëmë të mundur rezultatet e këtij punimi.

Një falenderim të veçantë për kolegët e Programit Kombëtar të HIV/AIDS, dhe stafin e shoqatës “STOP AIDS” pa bashkëpunimin e të cilëve ky punim nuk do të ishte bërë i mundur.

## Abstrakt

Një nga sfidat me të cilat përballemi sot është ruajtja e një prevalencë të ulët të infeksionit HIV në Shqipëri dhe adresimi i problemeve të stigmës dhe diskriminimit, për të bërë të mundur që popullatat kryesore të kenë akses në shërbimet e parandalimit dhe trajtimit të HIV-it. Pavarësisht prevalencës relativisht të ulët të HIV-it dhe IST-ve të tjera midis popullatave kyçe në Shqipëri, të dhënat kanë treguar se ata angazhohen në sjellje që i vënë në rrezik për transmetimin e HIV dhe IST. Ky studim prezanton gjetjet nga Studimi e Mbikëqyrjes Biologjike të Sjelljes HIV (IBBS) të kryer te Përdoruesit e Drogave me Injektiv (PDI), Meshkujt që kryejnë Seks me Meshkuj dhe popullatën romë. U mat prevalenca e HIV, Hepatitit C dhe Sifilisit. Përveç kësaj, u mbledhën informacione në lidhje me praktikën e injektimit, sjelljet e rrezikshme seksuale, mbulimin me programe parandaluese, stigmën, njohuritë dhe testimin për HIV dhe simptomat e IST-ve.

Të dhënat u mbledhën duke përdorur metodologjinë e kampionimit të udhëhequr nga përgjigjedhësi (RDS) për të rekrutuar popullatat e MSM dhe PDI. Shumica dërrmuese e popullatës së PDI-ve raportojnë se kanë përdorur ndonjë drogë të paligjshme për më shumë se 5 vjet dhe tre të katërtat e tyre kanë injektuar për më shumë se pesë vjet. Shumica e tyre injektuan dy ose më shumë herë në ditë; droga e injektuar më shpesh në muajin e kaluar ishte heroina (99.2%). 25% e PDI-ve vlerësohet të kenë injektuar me agje ose shiringë të përdorur në injektimin e fundit dhe rreth 16% e tyre kanë injektuar gjithmonë ose shumicën e kohës drogë me agje të përdorura gjatë muajit të kaluar. Më shumë se gjysma (58%) e MSM-ve kryen seks anal me një partner seksual mashkull me pagesë. Një e katërta e atyre që kanë pasur marrëdhënie seksuale me një partner me pagesë kanë raportuar se kanë paguar një mashkull për të kryer seks anal gjatë gjashtë muajve të fundit. Shumica e tyre (86%) raportuan se kishin përdorur prezervativ herën e fundit që blenë seks anal nga një partner mashkull, dhe dy të tretat (67%) raportuan përdorimin e vazhdueshëm të prezervativit me këta partnerë. Nëntë në dhjetë MSM (89%) që kishin marrëdhënie seksuale me një partner treme pagesë, raportuan se ishin paguar nga një burrë për të kryer seks anal në 6 muajt e fundit. 80% e tyre raportuan se kishin përdorur prezervativ herën e fundit që i shitën seks anal një partneri mashkull, dhe më shumë se gjysma (54%) raportuan se kishin përdorur gjithmonë prezervativ, raportuan se kishin përdorur gjithmonë prezervativ kur u shisnin seks partnerëve meshkuj gjatë gjashtë muajve të fundit. .

Kombinimi i faktorëve të rrezikut të lidhur me HIV te popullata e MSM-ve e bën të domosdoshme që ky grup të synohet si pjesë e çdo strategjie parandaluese të HIV-i, si dhe ekziston nevoja për të përdorur qasje inovative për të rritur aksesin e MSM në shërbimet e parandalimit dhe testimit të HIV-it. Gjetjet te PDI nxjerrin në pah nevojën e forcimit të aktiviteteve të informacionit, edukimit dhe reduktimit të dëmit, të përshtatura për nevojat specifike të PDI-ve. Përveç kësaj, është e nevojshme të sigurohet që programet e reduktimit të dëmit të përfshijnë dhe të zhvillojnë më tej strategji për përmirësimin e sjelljeve mbrojtëse te PDI.

***Fjalë kyçe:** HIV, Shqipëria, PDI, MSM sjellja seksuale, përdorimi i drogës me injektiv, kampionim të udhëhequr nga përgjigjedhësi*

## Abstract

One of the challenges we face is to maintain a low prevalence of HIV infection in Albania and addressing the problems of stigma and discrimination, to make it possible for key populations, to access HIV prevention and treatment services. Despite the relatively low HIV and other STI prevalence among key populations in Albania, data have shown they are engaging in behaviors that put them at risk for HIV and STI transmission.

This study presents the findings from the HIV Biological Behavioral Surveillance Survey (IBBS) conducted among PWID, MSM and Roma population. The prevalence of HIV, Hepatitis C and Syphilis was measured. In addition, information was collected about their injection practices, sexual risk behaviors, HIV and other program coverage, stigma discrimination and violence, HIV knowledge and testing, and STI signs and symptoms.

Data were collected using respondent driven sampling methodology (RDS) to recruit and MSM PWID. The vast majority of PWID population report to have used any illicit drug for more than 5 years and three-quarters of them have injected for more than five years. Majority of them inject two or more times a day; the most commonly used injectable drugs in the past month was heroin (99.2%). 25% of PWID are estimated to have injected with a used needle or syringe at last injection and about 16% of them have always or most of the time injected drugs with used needles during the past month; and about 42% of respondents have shared needles/syringes in the past month. More than half (58%) of MSM had anal sex with a commercial male sex partner in the 6 months preceding the survey. One-fourth of those who had sex with a commercial partner reported paying a male to have anal sex in the past six months. The majority of them (86%) reported using a condom the last time they bought anal sex from a male partner, and two-third (67%) reported consistent condom use with these partners. Nine in ten MSM (89%) who had sex with a commercial partner, reported being paid by a man to have anal sex in the past 6 months. 80% of them reported using a condom the last time they did sell anal sex to a male partner, and more than half (54%) reported always using a condom reported always using a condom when selling sex to male partners in the past six months.

The combination of HIV related risk factors among MSM population makes it imperative that this group be targeted as part of any HIV prevention strategy, and there is a need to use innovative approaches to increase access of MSM to HIV prevention and testing services. These findings highlight the need of strengthening information, education and harm reduction activities, tailored to specific needs of PWID. In addition, there is need to ensure harm-reduction programs include and further develop strategies for improving protective behaviors among PWID.

**Keywords:** *HIV, Albania, PWID, MSM sexual behavior, injecting drug use, respondent-driven sampling*

## Tabela e permbajtjes

Parathënie .....	i
Falenderime .....	ii
Abstrakt .....	iii
Abstract.....	iv
Lista e figurave .....	ix
Lista e tabelave .....	ix
<b>KAPITULLI I. HYRJE .....</b>	<b>xiii</b>
1.1 Hyrje.....	xiii
1.2 Popullatët kyçe dhe grupet e vulnerabël.....	xiii
1.2.1 Popullatat kyç.....	xiii
1.2.2 Popullatat e cënueshme .....	xv
1.2.3 HIV në popullatat kyç .....	xv
1.3 Përdoruesit e drogave me injektim .....	xvi
1.3.1 Praktikrat e injektimit të drogës. Kohëzgjatja e injektimit .....	xvii
1.3.2 Seksi i pambrojtur .....	xviii
1.3.3 Programet e shkëmbimit të ageve dhe shiringave .....	xix
1.4 Meshkujt që kryejnë seks me meshkuj .....	xx
1.4.1 Seksi me pagesë .....	xx
1.4.2 Prevalenca e IST te popullata MSM .....	xxi
1.4.3 Faktorët që lidhen me HIV .....	xxii
1.4.4 Seksi i pambrojtur. Numri i partnerëve seksualë .....	xxiii
1.4.5 Faktorët të lidhur me seksin të pambrojtur .....	xxiii
1.5 Punonjëset e seksit .....	xxiv
1.5.1 Sjelljet e rrezikshme seksuale .....	xxv
1.6 Survejanca te popullata kyç.....	xxv
1.6.1 Vlerësimi i prevalencës së HIV dhe sjelljes së rrezikut .....	xxv
1.6.2 Matja e madhësive të popullatave për MSM , PDI dhe PS .....	xxvi
1.7 Të dhënat epidemiologjike të HIV/AIDS Shqipëri .....	xxvii
1.8 Popullatat Kyç në Shqipëri .....	xxvii
1.8.1 Vlerësimi i madhësive se popullatave kyç .....	xxvii
1.8.2 Përdoruesit e Drogave me Injektim (PDI).....	xxviii
1.8.3 Meshkuj që kryejnë seks me meshkuj (MSM) .....	xxix
1.8.4 Punonjëset e seksit .....	xxx
1.8.5 Popullata rome .....	xxx
<b>KAPITULLI II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT .....</b>	<b>1</b>
2.1 Qëllimi i studimit.....	1
2.2 Objektivat e studimit .....	1
2.2.1 Objektivi i përgjithshëm 1.....	1

2.2.1.1	Objektivat specifike për objektivin e përgjithshëm 1	1
2.2.2	Objektivi i përgjithshëm 2	2
2.2.2.1	Objektivat specifike për objektivin e përgjithshëm 2	2
2.2.3	Objektivi i përgjithshëm 3	3
2.2.3.1	Objektivat specifike për objektivin e përgjithshëm 3	3
2.2.4	Objektivi i përgjithshëm 4	3
2.2.4.1	Objektivat specifike për objektivin e përgjithshëm 4	3
2.2.5	Objektivi i përgjithshëm 5	4
2.2.5.1	Objektivat specifike për objektivin e përgjithshëm 4	4
2.3	Hipotezat e studimit	4
	<b>KAPITULLI III. METODOLOGJIA</b>	6
3.1	Tipi i studimit	6
3.2	Kampionimi	6
3.3	Kriteret e pranimit dhe kriteret përjashtuese	7
3.4	Madhësia e kampionit	8
3.5	Procesi i rekrutimit	9
3.6	Pasqyra e rekrutimit	10
3.6	Mbledhja e të dhënave	15
3.7	Procedurat laboratorike	15
3.8	Analiza statistikore e të të dhënave	15
3.9	Konsiderata etike	17
	<b>KAPITULLI IV. REZULTATET</b>	17
4.1	Përdoruesit e Drogave me Injektivim	17
4.1.1.	Karakteristikat socio-demografike të PDI	17
4.1.2.	Përdorimi i alkoolit dhe drogës	18
4.1.2.1	Alkooli	18
4.1.2.2	Droga	19
4.1.2.2.1	Mosha në përdorimin dhe injektimin e parë të drogës	19
4.1.2.2.2	Kohëzgjatja e përdorimit dhe injektimit të drogës	19
4.1.2.3	Shpeshësia e injektimit të drogës në muajin e fundit	20
4.1.2.4	Llojet e drogës të përdorur dhe injektuar në muajin e fundit	21
4.1.2.5	Sjelljet e shkëmbimit të ageve dhe pajisjeve të injektimit	23
4.1.2.5.1	Injektimi me age/shiringë sterile në injektimin e fundit të drogës	23
4.1.2.5.2	Frekuenca e injektimit me age të përdorura në muajin e kaluar	23
4.1.2.5.3	Shkëmbimi i ageve/shiringave në muajin e fundit	24
4.1.2.5.4	Shpeshësia dhe mënyra e pastrimit të ageve/shiringave dhe injektimi me age të pastra gjatë muajit të fundit	26
4.1.2.5.5	Dhënia, huazimi, shitja ose marrja me qera e ageve dhe shiringave të përdorura	28
4.1.2.6	Shkëmbimi i pajisjeve të injektimit	30



4.1.2.6.1 Shpeshhtësia e shkëmbimit të pajisjeve të injektimit në muajin e fundit.....	30
4.1.2.7 . Trajtimi i drogës .....	33
4.1.2.7.1 Llojet e trajtimit dhe ndihmës së marrë .....	34
4.1.3. Sjellja seksuale dhe përdorimi i prezervativit.....	35
4.1.3.1 Mosha në mardhënien e parë seksuale.....	35
4.1.3.2 Partnerët e rregullt .....	36
4.1.3.2.1 Përdorimi i prezervativit.....	36
4.1.3.2.2 Arsyet për të mospërdorimin e prezervativit në mardhënien e fundit seksuale me partnerin e rregullt.....	37
4.1.3.3 Partnerët seksualë me pagesë .....	38
4.1.3.3.1 Përdorimi i prezervativit.....	38
4.1.3.4 Partnerët seksualë jo të rregullt, pa pagesë.....	38
4.1.3.4.1 Përdorimi i prezervativit.....	38
4.1.3.4.2 Arsyet për mos përdorimin e prezervativit në seksin e fundit me partnerin seksual jo të rregullt, pa pagesë.....	39
4.1.3.5 Prezervativi mashkullor .....	40
4.1.3.5.1 Përdorimi i prezervativit në mardhënien e fundit me çdo lloj partneri .....	40
4.1.3.5.2 Njohuri se ku mund të sigurohet prezervativi .....	41
4.1.4. Njohuri për IST.....	42
4.1.4.1 Dëgjuar për IST .....	42
4.1.4.2 Historia e IST-ve dhe Sjelljet e Lidhura me Kërkimin e Mjekimit .....	43
4.1.5. Akses në shërbime.....	43
4.1.5.1 Koha e kontaktit me edukatorë bashkëmohatarë ose punonjës terreni.....	44
4.1.6. Njohuri për HIV/AIDS .....	45
4.1.7. Njohuritë dhe sjelljet për testimin HIV .....	46
4.1.8. Stigma dhe diskriminimi ndaj personave që jetojnë me HIV/AIDS (PJHIV) .....	48
4.1.9. Stigma dhe diskriminimi ndaj PDI-ve .....	49
4.1.9.1 Shmangia e kërkimit të shërbimeve shëndetësore në 12 muajt e fundit.....	50
4.1.9.2 Dhuna ndaj PDI-ve .....	51
4.1.9.3 Injektimi i drogës dhe ndarja e pajisjeve të injektimit në mjediset e burgut .....	51
4.1.10. Të dhëna biologjike.....	52
4.1.11. Sjelljet e rrezikshme të lidhura me injektimin, mardhëniet seksuale dhe aksesin në shërbime sipas grupmoshës .....	52
4.1.11.1 Karakteristikat socio-demografike sipas grupmoshës .....	52
4.1.11.2 Sjelljet e lidhura me injektimin drogës sipas grupmoshës.....	53
4.1.11.3 Aksesin në shërbime sipas grupmoshës .....	54
4.1.11.4 Përdorimi i prezervativit sipas grupmoshës.....	55
4.1.12.Sjelljet e rrezikshme të lidhura me injektimin, mardhëniet seksuale dhe aksesin në shërbime sipas statusit të Hepatitit C .....	56
4.1.12.1 Karakteristikat socio-demografike sipas statusit të Hepatitit C .....	56

4.1.12.2 Sjelljet e lidhura me injektimin drogës statusit të Hepatitit C .....	56
4.12.3 Aksesit në shërbime sipas statusit të Hepatitit C .....	57
4.1.13. Faktorët kryesorë të lidhur me shpeshësinë e injektimit, shkëmbimin e shiringave, ndarjen e pajisjeve të injektimit dhe Hepatitin C .....	58
4.1.13.1 Faktorët e lidhur me Hepatitin C .....	58
4.1.13.2 Faktoret e lidhur me shkëmbimin e ageve/shiringave.....	59
4.1.13.3 Faktoret e lidhur me ndarjen e pajisjeve të injektimit.....	60
4.2 Meshkujt që kryejnë seks me Meshkuj.....	61
4.2.1. Karakteristikat socio-demografike të MSM-ve.....	61
4.2.2 Përdorimi i alkoolit dhe drogës .....	62
4.2.3 Sjelljet seksuale dhe përdorimi i prezervativit.....	63
4.2.3.1 Seksi oral.....	63
4.2.3.2 Seksi anal .....	63
4.2.4 Sjelljet seksuale me lloje të ndryshme partnerësh .....	64
4.2.4.1 Partnerët seksualë meshkuj me pagesë.....	64
4.2.4.1.1 Partnerët seksualë meshkuj me pagesë (pjesëmarrësi ka paguar në këmbim të seksit).....	64
4.2.4.1.2 Pagesa e partnerëve seksualë meshkuj (pjesëmarrësi mori para në këmbim të seksit).....	64
4.2.4.2 Partnerët seksualë meshkuj të rregullt .....	65
4.2.4.3 Partnerë seksual jo të rregullt, pa pagesë.....	66
4.2.4.4 Partneret seksuale femra.....	67
4.2.5 Njohuri të përgjithshme dhe përdorimi i prezervativit dhe lubrifikantëve .....	67
4.2.6 Njohuri dhe qëndrimet për HIV/AIDS .....	68
4.2.7 Infeksionet e seksualisht të transmetueshëm (IST) .....	70
4.2.8 Këshillim dhe testimi për HIV .....	71
4.2.9 Perceptimet dhe qëndrimet ndaj njerëzve që jetojnë me HIV .....	71
4.2.10 Stigma dhe diskriminimi ndaj MSM.....	72
4.2.11 Profilaksia para dhe pas ekspozimit .....	73
4.2.12 Aksesit në shërbime.....	74
4.2.13 Të dhëna biologjike.....	74
4.2.14. Sjelljet e rrezikshme të lidhura me marrëdhëniet seksuale dhe aksesit në shërbime sipas grupmoshës.....	75
4.2.14.1 Karakteristikat socio-demografike grupmoshës .....	75
4.2.14.2 Aksesit në shërbime sipas grupmoshës .....	76
4.2.14.3 Përdorimi i prezervativit sipas grupmoshës .....	77
4.2 Popullata Rome .....	78
4.2.1 Karakteristikat socio-demografike.....	78
4.2.2 Përdorimi i alkoolit dhe drogës .....	79
4.2.3 Sjelljet seksuale dhe përdorimi i prezervativit.....	80

<b>4.2.4 Njohuri për HIV/AIDS</b> .....	81
<b>4.2.5 Njohuritë dhe Sjelljet për Testimin e HIV</b> .....	82
<b>KAPITULLI V. DISKUTIMI</b> .....	83
<b>Përdoruesit e Drogave me Injektiv</b> .....	83
<b>Meshkujt që kryejnë seks me meshkuj</b> .....	87
<b>Popullata Rome</b> .....	90
<b>KAPITULLI VI. PËRFUNDIME</b> .....	92
<b>KAPITULLI VII. REKOMANDIME</b> .....	94
<b>REFERENCAT</b> .....	96

## Lista e figurave

Figura 1. Zinxhiri i rekrutimit të MSM-ve, Tiranë .....	11
Figura 2. Zinxhiri i rekrutimit të MSM-ve, Durrës .....	12
Figura 3. Zinxhiri i rekrutimit të MSM-ve, Elbasan .....	12
Figura 4. Zinxhiri i rekrutimit të PDI-ve, Tiranë .....	13
Figura 5. Zinxhiri i rekrutimit të PDI-ve, Durrës .....	13
Figura 6. Zinxhiri i rekrutimit të PDI-ve, Elbasan .....	14
Figura 7. Zinxhiri i rekrutimit të PDI-ve, Berat .....	14

## Lista e tabelave

Tabela 1: Përmbledhje e vlerësimeve rajonale dhe kombëtare për Personat që Injektojnë Drogë, Meshkujt që kryejnë seks me Meshkuj, dhe Punonjëseve Femra të Seksit .... xxviii	
Tabela 2. Madhësia e përlllogaritur e kampionit për MSM, PDI dhe popullatën rome. (ne kllapa madhësia e arritur).....	9
Tabela 3. Moshë, seksi dhe arsimimi i PDI .....	17
Tabela 4. Përdorimi i alkoolit .....	18
Tabela 5. Moshë në përdorimin dhe injektimin e parë të drogës .....	19
Tabela 6. Kohëzgjatja e përdorimit dhe injektimit të drogës .....	20
Tabela 7. Droga të përdorura dhe të injektuara në muajin e fundit .....	22
Tabela 8. Shpeshtësia e injektimit me agje të përdorura gjatë muajit të kaluar .....	23
Tabela 9. Shkëmbimi i ageve/shiringave në muajin e fundit .....	24
Tabela 10. Shpeshtësia dhe mënyra e pastrimit të ageve dhe injektimit me agje të pastra në muajin e fundit .....	27
Tabela 11. Shpeshtësia e huazimit, shitjes, marrjes me qera të ageve të përdorura në muajin e fundit .....	28

Tabela 12. Parambushja, pasmbushja, ndarja e dozës në muajin e fundit .....	30
Tabela 1. Shpeshësia e shkëmbimit të pajisjeve të injektimit në muajin e fundit .....	30
Tabela 14. Aftësia për të siguruar age/shiringa të reja, të papërdorura kur nevojiten dhe njohja e vendeve/personave ku mund të sigurohen .....	31
Tabela 15. Në trajtim për shkak të përdorimit të drogës dhe lloji i trajtimit .....	33
Tabela 2. Mardhëniet seksuale dhe mosha në mardhënien e parë seksuale .....	35
Tabela 17. Partnerët e rregullt. Mardhëniet seksuale dhe përdorimi i prezervativit.....	36
Tabela 18. Arsyet e mospërdorimit të prezervativit në mardhënien e fundit seksuale partnerë të rregullt.....	37
Tabela 19. Partnerët e seksit me pagesë. Mardhëniet seksuale dhe përdorimi i prezervativit .....	38
Tabela 20. Partnerët e seksit jo të rregullt, pa pagesë. Mardhëniet seksuale dhe përdorimi i prezervativit .....	39
Tabela 21. Sygjerimi për përdorimin e prezervativit me partnerë seksualë jo të rregullt, pa pagesë.....	39
Tabela 22. Arsyet e mospërdorimit të prezervativit në seksin e fundit me partner seksual jo të rregullt, pa pagese .....	40
Tabela 23. Përdorimi i prezervativit .....	40
Tabela 24. Njohuri se ku mund të sigurohet prezervativi.....	41
Tabela 25. Njohuri për infeksionet seksualisht të transmetueshme .....	42
Tabela 26. Historia e IST-ve dhe Sjelljet e Lidhura me Kërkimin e Mjekimit .....	43
Tabela 27. Shërbimet e ofruara për popullatën e PDI në gjashtë muajt e fundit .....	44
Tabela 28. Koha e kontaktit me edukatorë bashkëmohatarë ose punonjës terreni.....	44
Tabela 29. Njohuritë për HIV/AIDS.....	45
Tabela 3. Interpretime jo të gabuara mbi transmetimin e HIV .....	46
Tabela 4. Njohuritë dhe sjelljet e testimit për HIV .....	47
Tabela 32. Stigma dhe diskriminimi ndaj personave që jetojnë me HIV/AIDS.....	48
Tabela 33. Stigma ndaj PDI.....	49
Tabela 34. Shmangia e kërkimit të shërbimeve shëndetësore dhe testimit për HIV në 12 muajt e fundit .....	50
Tabela 36. Të ngacmuar, lënduar ose arrestuar për shkak të injektimit të drogës .....	51
Tabela 37. Injektimi i drogës ne mjediset e burgut.....	52
Tabela 38. Prevalenca e HIV-it, Hepatitit C dhe sifilizit.....	52
Tabela 39. Karakteristikat socio-demografike të PDI sipas grupmoshës .....	53
Tabela 40. Sjelljet e lidhura me injektimin drogës të PDI sipas grupmoshës.....	54
Tabela 41. Aksesit në shërbime sipas grupmoshës .....	55
Tabela 42. Përdorimi i prezervativit me partner të ndryshëm sipas grupmoshës .....	55
Tabela 43. Karakteristikat socio-demografike sipas statusit të Hepatitit C .....	56
Tabela 44. Sjelljet e lidhura me injektimin drogës sipas statusit të Hepatitit C .....	57
Tabela 45. Aksesit në shërbime sipas statusit të Hepatitit C .....	58

Tabela 46 Faktorët e lidhur me Hepatitin C te PDI .....	59
Tabela 47. Faktorët e lidhur me shkëmbimin e ageve/shiringave .....	59
Tabela 48. Faktorët e lidhur me shkëmbimin e ageve/shiringave .....	60
Tabela 49. Moshë, arsimimi.....	61
Tabela 50. Gjendja martesore .....	61
Tabela 51. Lëvizshmëria.....	62
Tabela 52. Përdorimi i alkoolit dhe drogës.....	62
Tabela 53. Historia seksuale: seksi oral dhe përdorimi i prezervativit .....	63
Tabela 54. Lloji i marrëdhënies seksuale me meshkuj .....	64
Tabela 55. Seksi anal dhe përdorimi i prezervativit me partnerë tregtarë seksi meshkuj. 65	
Tabela 56. Seksi anal dhe përdorimi i prezervativit me partnerë të rregullt meshkuj .....	66
Tabela 57. Seksi anal dhe përdorimi i prezervativit partnerë seksualë meshkuj jo të rregullt, pa pagesë .....	66
Tabela 58. Sjelljet seksuale me partnere seksuale femra.....	67
Tabela 59. Njohja dhe përdorimi i prezervativëve dhe lubrifikantëve .....	68
Tabela 60. Njohuritë dhe qëndrimet për HIV/AIDS.....	69
Tabela 61. Njohuritë e IST-së.....	70
Tabela 62. Këshillimi dhe testimi për HIV .....	71
Tabela 63. Qëndrimet ndaj personave që jetojnë me HIV .....	71
Tabela 62 . Stigma dhe diskriminimi ndaj MSM.....	72
Tabela 65. PrEP dhe PEP.....	73
Tabela 66. Aksesit në shërbime .....	74
Tabela 67. Prevalenca e HIV dhe Sifilizit .....	74
Tabela 68. Karakteristikat socio-demografike të MSM sipas grupmoshës .....	75
Tabela 69. Fenomenet e lidhura me stigmën te MSM sipas grupmoshës.....	75
Tabela 70. Aksesit në shërbime te MSM sipas grupmoshës.....	76
Tabela 71. Përdorimi i prezervativit me partner të ndryshëm te MSM sipas grupmoshës.....	77
Tabela 72. Karakteristikat socio-demografike.....	78
Tabela 73. Përdorimi i alkoolit dhe drogës .....	80
Tabela 74. Sjelljet seksuale dhe përdorimi i prezervativit.....	80
Tabela 75. Njohuritë për HIV/AIDS.....	81
Tabela 76. Njohuritë për testimin HIV .....	82

## **Lista e grafikeve**

Grafiku 1. Shpeshësia e injektimit të drogës .....	20
Grafiku 2. Shpeshësia e injektimit të drogës sipas qyteteve.....	21
Grafiku 3. Prevalenca e drogave të përdorura dhe të injektuara gjatë muajit të fundit ...	21
Grafiku 4. Përdorimi i ages/shiringës sterile në injektimin e fundit të drogës .....	23

Grafiku 5. Numri i personave me të cilët kanë shkëmbyer age/shiringa në muajin e kaluar .....	25
Grafiku 6. Numri i personave me të cilët janë shkëmbyer age/shiringa në muajin e kaluar sipas qyteteve .....	26
Grafiku 7. Pastrimi i ageve/shiringave në muajin e fundit sipas grupmoshës dhe nivelit arsimor .....	28
Grafiku 8. Përdorimi i një shiringë të parambushur në muajin e fundit sipas qyteteve....	29
Grafiku 9. Burimet ku mund të sigurohen age/ shiringa të reja, të papërdorura kur është e nevojshme .....	32
Grafiku 10. Burimet për sigurimin ageve/shiringave të reja, të papërdorura kur nevojiten, sipas qyteteve .....	32
Grafiku 11. Përqindja e PDI në trajtim sipas grupmoshës dhe nivelit arsimor.....	34
Grafiku 12. Llojet e trajtimit dhe të ndihmës së marrë, sipas vendit të studimit .....	34
Grafiku 13. Llojet kryesore të trajtimit dhe ndihmës së marrë, sipas qytetit.....	35
Grafiku 14. Njohuritë lidhur me mënyrat e transmetimit të HIV .....	45
Grafik 15. Arsyet për të mos u testuar për HIV .....	48
Grafiku 16. Stigma dhe diskriminimi ndaj PJHIV.....	49

# KAPITULLI I. HYRJE

## 1.1 Hyrje

Të qënit PDI, MSM, TGJ ose PS nuk rrit rrezikun individual për marrjen ose transmetimin e HIV-it. Përkundrazi, rreziku rritet kur individët praktikojnë sjellje "të pasigurta" (p.sh. kryejnë marrëdhënie seksuale anale, vaginale të pambrojtura, apo ndajnë age/shiringa, pajisje injektimi josterile) me partnerë që kanë një status HIV të ndryshëm nga ta. Arsyeja kryesore që popullatat kyç janë në rrezik më të lartë për infektimin me virusin HIV është se prevalenca e HIV-it në rrjetet e tyre seksuale ose të shkëmbimit të ageve/shiringave është e lartë. Edhe pse anëtarët e popullatës së përgjithshme gjithashtu kryejnë seks të shpeshtë vaginal dhe anal të pambrojtur, gjasat e tyre për të pasur një partner të infektuar me HIV është shumë më e ulët se ajo e anëtarëve të popullatave kyç (1,2).

Politikat që kriminalizojnë sjelljet e popullatave kyç ose kufizojnë aksesin e tyre në shërbime mund të rrisin më tej rrezikun e tyre për marrjen dhe transmetimin e HIV-it. Në vendet ku sjelljet e PDI-ve, MSM-ve, TGJ-ve ose PS janë kriminalizuar, ndikimi negativ në aksesin në shërbime është edhe më i madh. Anasjelltas, ligjet që ndalojnë diskriminimin ndaj popullatave të caktuara ndërlidhen me akses më të mirë në shërbimet parandaluese nga këto popullata (3,4).

Faktorët socialë-strukturorë si stigma, ngacmimi, marginalizimi dhe mungesa e mbështetjes sociale mund të kontribuojnë në transmetimin më të lartë të HIV-it dhe infeksioneve të tjera. Kjo është veçanërisht e dukshme te popullatat e punonjëseve të seksit, pakicave seksuale dhe personave që injektojnë drogë (5,6). Margjinalizimi ose refuzimi social mund t'i shtyjë këta individë drejt izolimit, papunësisë, varfërisë dhe kushteve të paqëndrueshme të jetesës. Gjithashtu mund t'i ekspozojë ata ndaj dhunës fizike dhe seksuale, dhe mund të kufizojë aksesin e tyre në shërbimet parandaluese për HIV (7). Frika nga ngacmimi i policisë, arrestimi ose diskriminimi nga ofruesit e kujdesit shëndetësor mund të dekurajojë gjithashtu anëtarët e popullatave kyç që të kenë akses në shërbimet e parandalimit dhe trajtimit. Në një vlerësim të shërbimeve të parandalimit të HIV-it të disponueshme për MSM në 147 vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme, 55% nuk ishin në gjendje të dokumentonin as ofrimin e shërbimeve më elementare të lidhura me HIV-in (8).

## 1.2 Popullatët kyçe dhe të cënueshme

### 1.2.1 Popullatat kyç

Popullatat kyç janë grupe të përcaktuara që për shkak të sjelljeve specifike me rrezik më të lartë, janë në rrezik të shtuar për tu infektuar me virusin HIV, pavarësisht nga lloji i epidemisë ose konteksti lokal. Gjithashtu, ata shpesh kanë probleme ligjore dhe sociale që

lidhen me sjelljet e tyre dhe që rrisin cënueshmërinë e tyre ndaj HIV. Popullatat kyç janë të rëndësishme për dinamikën e transmetimit të HIV, dhe janë gjithashtu partnerë thelbësorë në një përgjigje efektive ndaj epidemisë së HIV/AIDS (9).

Sjelljet e rrezikshme dhe vulnerabiliteti i popullatave specifike dhe rrjeteve të tyre përcaktojnë dinamikën e epidemive të HIV-it. Grupet e popullatave kyç, pothuajse në të gjitha mjediset janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga HIV.

Këto rreziqe jo proporcionale pasqyrojnë sjelljet e anëtarëve të këtyre popullatave dhe barrierat specifike ligjore dhe sociale që rrisin më tej vulnerabilitetin e tyre. Popullatat kyç ndikojnë në dinamikën e epidemisë dhe luajnë një rol kyç në përcaktimin e natyrës dhe efektivitetit të përgjigjes ndaj HIV-it. Njerëzit që jetojnë me HIV janë në qendër të përgjigjes ndaj HIV-it dhe, për rrjedhojë, konsiderohen gjithashtu si një popullatë kyçe (10, 11).

Në shumicën e vendeve, mbulimi jo adekuat dhe cilësia e dobët e shërbimeve për popullatat kyç ndikojnë negativisht në përgjigjen ndaj HIV-it. Të gjitha vendet duhet të marrin parasysh rëndësinë e kapjes dhe mbulimit me shërbime të këtyre popullatave kyçe, të kuptuarit e nevojave të tyre dhe ofrimit të shërbimeve të barabarta, të aksesueshme dhe të pranueshme. Për të arritur këtë, është thelbësore të punohet me grupet dhe rrjetet kryesore të këtyre popullatave si partnerë në zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve (12,13).

Pa adresuar nevojat e popullatave kyç, nuk mund të arrihet një përgjigje e qëndrueshme ndaj HIV-it. Megjithatë, deri më sot, në shumicën e vendeve me epidemi të gjeneralizuar të HIV-it, përgjigja është fokusuar pothuajse ekskluzivisht në popullatën e përgjithshme. Edhe vendet që pranojnë se epidemitë e HIV-it janë të përqendruara në popullatat kyç, shpesh hezitojnë të zbatojnë ndërhyrje adekuate që arrijnë tek ata që kanë më shumë nevojë (14).

Një përgjigje efektive kërkon më shumë sesa shërbime dhe programe mbështetëse për popullatat kryesore. Ajo kërkon ndryshime sistemike dhe mjedisore që mund të arrihen vetëm me veprime e bashkërenduara Për anëtarët e popullatave kyç dhe grupeve të cënueshme, shumë faktorë që ndikojnë në rrezikun e një personi janë kryesisht jashtë kontrollit të atij personi. Veçanërisht për popullatat kyç, faktorët socialë, ligjorë, strukturorë dhe faktorë të tjerë kontekstualë rrisin cënueshmërinë ndaj HIV-it dhe pengojnë aksesin në shërbimet parandaluese dhe ato të trajtimit për HIV. Faktorë të tillë përfshijnë legjislacionin ndëshkues dhe praktikën e policisë, stigmën dhe diskriminimin, varfërinë, dhunën dhe nivelet e larta të të pastrehëve në disa nën-popullata. Këta faktorë ndikojnë se sa mirë individët ose popullatat mund të mbrohen nga infeksioni HIV dhe të përballen me të; ato mund të kufizojnë aksesin në informacion, shërbime parandaluese, si dhe në kujdes e trajtim. Për më tepër, shërbime të tjera shëndetësore specifike për nevojat e popullatave kyç janë shpesh të pakta ose inekzistente – për shembull, trajtimi që konfirmon gjininë për



personat transgjnorë dhe shërbimet e reduktimit të dëmit për personat që injektojnë drogë. Vendosja gjeografike dhe konteksti social gjithashtu mund të ndikojnë në cënueshmërinë e një personi (15,16, 17).

Anëtarët e të gjitha popullatave kyçe vazhdojnë të përjetojnë stigmë dhe diskriminim intensiv, barriera dhe kufizime ligjore për aksesin në shërbime dhe shpesh nuk janë prioritet politikave i shëndetësore publike. Në shumë mjedise, organizatat komunitare ofrojnë shërbime të rëndësishme për popullatat kyçe. Partneritetet dhe lidhjet më të mira ndërmjet organizatave komunitare dhe strukturave publike shëndetësore janë thelbësore. Aksesin i barabartë dhe sigurimi i shërbimeve shëndetësore të lidhura me popullatat kyçe janë një prioritet i përgjigjes kombëtare të HIV, që kërkon financim adekuat të brendshëm dhe të jashtëm (18, 19, 20)

### **1.2.2 Popullatat e cënueshme**

Popullatat e cënueshme janë grupe njerëzish që janë veçanërisht të prekshëm ndaj infeksionit HIV në situata ose kontekste të caktuara, të tilla si adoleshentët, jetimët, fëmijët e rrugës, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe punëtorët migrantë dhe ata sezonalë. Këto popullata nuk janë të prekura nga HIV në mënyrë të njëjtë në të gjitha vendet dhe epidemitë (21,22)

Në disa kontekste, grupe të tjera janë gjithashtu veçanërisht të prekshëm ndaj infeksionit HIV, për shembull, punëtorët migrantë, refugjatët, shoferët e kamionëve të distancave të gjata, personeli ushtarak, gratë e reja. Këto popullata nuk janë njësoj të cënueshme ose njësoj të prekura në vende të ndryshme dhe mjedise epidemike të ndryshëm. Duhet bërë përpjekje për të identifikuar këto popullata në mjediset e tyre specifike dhe të zhvillohen ndërhyrje dhe shërbime të përshtashme për to në përputhje me rrethanat (23).

Në përgjithësi, vendet duhet t'i japin përparësi përgjigjeve të tyre ndaj HIV-it për t'u fokusuar tek popullatat që janë më të cënueshme, që përjetojnë barrën më të madhe të HIV-it dhe që aktualisht nuk mbulohen me shërbime. Këto popullata do të përfshijnë si popullatat specifike të cënueshme, ashtu edhe, në të gjitha mjediset, popullata kryesore. OBSH ofron rekomandime për pesë popullatat kryesore të listuara më sipër (si të rriturit ashtu edhe adoleshentët), ndërkohë që vendet do të duhet të përshtatin përgjigjen e tyre dhe të adresojnë nevojat e popullatave vulnerabël (24, 25).

### **1.2.3 HIV në popullatat kyçe**

Të dhënat e situatës epidemiologjike mbështesin arsyetimin që programet e parandalimit të HIV të fokusohen në popullatat kyçe. Në shumë mjedise, incidenca e HIV-it në popullatën e përgjithshme është stabilizuar ose ka rënë. Megjithatë, globalisht, popullatat kyçe

vazhdojnë të përjetojnë barrë të konsiderueshme të HIV-it dhe kanë një ndikim në dinamikën e epidemive të HIV-it (26, 27, 28).

Në përgjithësi, të dhënat shëndetësore, duke përfshirë të dhënat e prevalencës së HIV-it, janë më pak të qëndrueshme për popullatat kyç sesa për popullatat e përgjithshme për shkak të kompleksitetit në përzgjedhjen e kampioneve (dhe mungesës së të dhënave për vlerësimin e madhësisë), problemeve ligjore dhe çështjeve të stigmës dhe diskriminimit. Ligjet që kriminalizojnë sjelljen e popullatave kyçe e bëjnë të vështirë mbledhjen e të dhënave përfaqësuese (29, 30).

### **1.3 Përdoruesit e drogave me injektim**

Personat që injektojnë drogë u referohet personave që injektojnë substanca psikotrope (ose psikoaktive) për qëllime jo mjekësore. Këto barna përfshijnë, por pa u kufizuar në, opioidet, stimuluesit e llojit amfetamine, kokainën, hipno-sedativët dhe halucinogjenët. Injektimi mund të bëhet me rrugë intravenoze, intramuskulare, nën-lëkurë ose rrugë të tjera injektuese. Njerëzit që vetë-injektojnë medikamente për qëllime mjekësore – të referuara si “injeksione terapeutik” – nuk përfshihen në këtë përkufizim. Përkufizimi gjithashtu nuk përfshin individë që vetë-injektojnë substanca jo psikotrope, të tilla si steroide ose hormone të tjera, për formësimin e trupit ose përmirësimin e performancës atletike (31, 32).

Përdorimi i drogës me injektim është një shqetësim i madh shëndetësor global, me 11 deri në 21 milionë njerëz që injektojnë drogë në mbarë botën. Në përgjithësi, ka rreth 4.8 milionë persona që injektojnë drogë (PDI) në rajonin evropian, me mbi 1.8 milionë prej tyre jetojnë në Federatën Ruse(33, 34).

Në Europë, prevalenca e injektimit të drogës në popullatën e përgjithshme ndryshon gjerësisht nga pothuajse zero në disa vende të Evropës Qendrore (për shembull Hungari) në më shumë se një në njëzet të rritur (për shembull në Azerbajxhan) (35). Viruset e transmetuara nëpërmjet gjakut, duke përfshirë HIV-in, kontribuojnë ndjeshëm në sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë e shtuar të PDI (36,37). HIV-i ka potencialin të përhapet me shpejtësi nëpërmjet shkëmbimit të ageve dhe shiringave të PDI, si dhe nëpërmjet seksit të pambrojtur midis PDI dhe partnerëve të tyre injektues dhe jo-injektues. Kontakti seksual midis PDI-ve dhe popullatave jo-injektuese mund të shpjegojë pjesërisht rritjen e rasteve të HIV në popullatën e heteroseksualëve jo-injektues në zonat ku përdorimi i drogës me injektim mendohej më parë të ishte rruga kryesore e transmetimit të HIV-it (38). Rreziku i infektimit me HIV pas injektimit me një age të kontaminuar është i lartë, vlerësohet të jetë rreth një në 125 injeksione, krahasuar me seksin e pambrojtur midis heteroseksualëve që mbart një rrezik transmetimi prej rreth një në 2000 – 5000 akte seksuale (39,40). Kjo shpjegon një farë mënyre barrën joproportionale të HIV në popullatën e PDI-ve në rajon.

Studimet sugjerojnë se tre herë më shumë meshkuj sesa femra injektojnë drogë në Evropë. Meshkujt përbëjnë një përqindje më të lartë të PDI-ve në Evropën Juglindore, Azinë Qendrore dhe Kaukaz. Të dhënat nga Gjeorgjia dhe Azerbajxhani tregojnë se mbi 95% e të anketuarve ishin meshkuj. (41,42,43,44,45) Shumica e kërkimeve të popullata e PDI-ve priren të rekrutojnë përmes shërbimeve ose në komunitet nëpërmjet rrjeteve të përdoruesve të drogës, kështu që ata pa akses në shërbime ose me lidhje të dobëta me rrjete të tilla mund të kenë më pak gjasa të përfshihen në një studim. Femrat përdoruese të drogave me injektim janë përgjithësisht më të vështira për t'u arritur se sa meshkujt dhe përdorin më pak shërbimet dhe kështu mund të nënperfaqësohen në studime. Në Gjeorgji, për shembull, vlerësohet se ka rreth 8,000 PDI femra, që është afërsisht 20% e përdoruesve problematikë të drogës, dhe megjithatë gratë përbëjnë vetëm rreth 8% të pjesëmarrësve të arritur nga programet e reduktimit të dëmit dhe 1% të arritur nga programet e metadonit (46).

### **1.3.1 Praktikë e injektimit të drogës. Kohëzgjatja e injektimit**

Kohëzgjatja e karrierës së injektimit ndryshon në të gjithë rajonin, dhe gjithashtu në nivel vendi, por dëshmitë sugjerojnë se PDI në Perëndim kanë injektuar mesatarisht për më shumë se 10 vjet dhe në Lindje nga dy deri në tetë vjet. Në Europën Qendrore, kohëzgjatja e injektimit varionte nga pesë deri në dhjetë vjet (47, 48, 49). Një rishikim i të dhënave spitalore në Izrael raportoi një kohëzgjatje mesatare të injektimit më pak se një vit në popullatën e PDI-ve (56). Në përgjithësi, studimet sugjerojnë se mesatarisht PDI femra kanë injektuar për një kohë më të shkurtër se homologët e tyre meshkuj, megjithëse një studim nga Shën Petersburg raportoi se si meshkujt ashtu edhe femrat kishin një karrierë mesatare injektuese prej pesë vitesh (18). Një studim në Mbretërinë e Bashkuar zbuloi se PDI që raportuan se merrnin shumicën e pajisjeve të tyre të injektimit përmes shpërndarjes dytësore kishin karrierë më të shkurtër injektimi (mesatarisht 6.4 vjet) sesa PDI që merrnin shumicën e pajisjeve të tyre nga farmacitë (mesatarisht 9.2 vjet) ose nga një shërbim me prag të ulët (mesatarisht 9.0 vjet) (50).

Në Perëndim, ndërmjet 5% dhe 32% e PDI-ve raportojnë se kanë shkëmbyer age shiringa në katër javët e fundit (51, 52) Frekuenca e shkëmbimit të ageve/shiringave në Lindje është më e larmishme, duke variuar nga 2% në 79% dhe vetëm në Federatën Ruse midis 8% dhe 79% (53, 54). Ndër studimet ruse, shpeshësia e shkëmbimit u rrit me moshën: shpeshësia më e ulët e raportuar ishte ajo nga një studim i kufizuar teka ata që kanë filluar të injektojnë së fundmi (injektimi për më pak se 3 vjet), të cilët ishin mesatarisht pesë vjet më të rinj se ata që raportuan shpeshësinë më të lartë të shkëmbimit të shiringave (19.6 vjet kundrejt 24.3 vjet) (55, 56). Duke përjashtuar këto rezultate ekstreme, shumica e studimeve nga Federata Ruse raportuan norma që varionin nga 12% deri në mbi 50%. Në Taxhikistan, 65% e PDI-ve raportuan se kishin injektuar me një age/shiringë të përdorur më parë në gjashtë muajt e fundit (57). Të dhënat nga Uzbekistani dhe Taxhikistani sugjerojnë se ndërsa vetëm 10% e të rinjve që injektojnë drogë kanë shkëmbyer age/shiringë në

injektimin e tyre të fundit, ndërkohë që ndarja e pajisjeve të injektimit konsiderohet një normë sociale (58).

Shumë studime kanë hulumtuar lidhjen midis HIV-it dhe injektimit me një age të përdorur, ose shkëmbimit të shiringave, por jo gjithmonë duke specifikuar nëse ato janë marrë apo dhënë për tu përdorur. Shumica e studimeve sugjerojnë rritje të rrezikut të HIV-it të lidhur me përdorimin e ages/shiringave të përbashkëta, po shumica e rezultateve janë jokonkluzive. Më definitivisht, injektimi me një age të përdorur më parë nga dikush që dihet se ka HIV ose hepatit C është treguar në shumicën e studimeve të jetë qartësisht i lidhur pozitivisht (59). Injektimi i përditshëm është gjetur gjithashtu të jetë i lidhur me rritjen e rrezikut të HIV-it. Për shembull, një studim në Volgograd, Federata Ruse zbuloi se personat që injektojnë përditë kanë 7 herë më shumë gjasa për HIV sesa ata që injektojnë më rrallë (95% IB 1.9 – 25.1) (60).

Të dhënat nga Federata Ruse, Serbia dhe Irlanda sugjerojnë se gjasat për të qenë HCV pozitiv rriten me moshën ose kohëzgjatjen e karrierës së injektimit. (61, 62) Faktorë të tjerë individualë të rrezikut për pozitivitetin e HCV përfshijnë injektimin e përditshëm ose të shpeshtë, dhe ndarjen e pajisjeve të injektimit. (63, 64, 65) Faktorët strukturorë janë gjetur gjithashtu të lidhur me rrezikun e HCV. Përvojat e burgimit ose e kontaktit me agjencitë e zbatimit të ligjit shfaqen si një faktor rreziku për pozitivitetin e HCV në disa mjedise. Në Serbi dhe Gjeorgji, rreziku i shtuar i HCV lidhej me të qenit ndonjëherë në burg, në Mal të Zi me arrestimin nga policia vitin e fundit, dhe në Tashikistan me arrestimin ndonjëherë (66, 67).

### **1.3.2 Seksi i pambrojtur**

Normat e raportuara të praktikave seksuale të rrezikshme (përgjithësisht të matura nga raportet seksuale vaginale ose anale të pambrojtura) në përgjithësi ishin shumë më të larta në mesin e PDI-ve në rajon sesa praktikat e pasigurta të injektimit. Megjithatë, PDI në të gjithë Evropën kishin më shumë gjasa të përdornin një prezervativ me partnerët e tyre të rastësishëm sesa me ato të rregullt. Në Perëndim niveli i përdorimit jo të vazhdueshëm të prezervativit ishte midis 72% dhe 83% me partnerët e rregullt dhe midis 28% dhe 44% me partnerët e rastësishëm. Në Lindje, këto nivele variojnë midis 28% dhe 94% raportuan përdorim jo të rregullt të prezervativit me partnerët e rregullt dhe 2% dhe 87% e bëjnë këtë me partnerë të rastësishëm. Në rajonin Qëndror Europian, një studim nga Sofja, Bullgari tregoi se meshkujt raportuan më pak përdorim jo të vazhdueshëm të prezervativit se femrat: 72% krahasuar me 90% me partnerë të rregullt dhe 44% krahasuar me 61% me partnerë të rastësishëm (68). Anasjelltas në Tashkent, Uzbekistan, 90% e meshkujve dhe 82% e femrave raportuan përdorim jo të rregullt të prezervativit me partnerët e tyre të rregullt dhe 80% e meshkujve dhe 60% e femrave me partnerin(ët) e tyre të rastësishëm (69,70).

### 1.3.3 Programet e shkëmbimit të ageve dhe shiringave

Te dhënat e disponueshme tregojnë se ka një variacion të konsiderueshëm në vlerësimin e mbulimit me programe të shkëmbimit të shiringave (PSHSH), ashtu si dhe dhe vetë mbulimi në vetëvete mund të matet në mënyra të ndryshme (71). Në shumë raste “mbulimi” përcaktohet si numri i ageve/shiringave të shpërndara për PDI në vit. Të dhënat nuk përfshijnë sigurimin e tyre në farmacitë të cilat mund të përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të atyre në qarkullim, veçanërisht në rajonin e Europës Lindore. Rregullat e funksionimit të PSHSH-ve mund të ndryshojnë, disa ofrojnë shpërndarje të pakufizuar të ageve/shiringave, të tjera ofrojnë vetëm shkëmbim. Disa PSHSH kufizojnë numrin e ageve/shiringave që mund të shkëmben, duke rritur numrin e kontakteve që një person ka me një shërbim dhe duke i detyruar ata të mbajnë aget e përdorura për periudha më të gjata kohore sesa do të duheshin. Kjo mund të rrisë gjasat e ripërdorimit të ageve/shiringave si dhe të rrisë gjasat e ngacmimit nga ana e policisë në disa vende (72, 73, 74). Ai gjithashtu nuk merr parasysh shpërndarjen e mundshme dytësore dhe mund të nënvlerësojë numrin e PDI-ve që përfitojnë nga programet e shkëmbimit të shiringave. Së fundmi, numri i ageve/shiringave që i nevojiten një PDI për të bërë çdo injeksion me një age sterile do të varet nga përdorimi i tyre personal i drogës, i cili mund të përfshijë kohëzgjatjen e injektimit, llojet e drogave të injektuara si dhe nëse përdorin ose jo Terapi Zëvendësuese të Opioidëve (TZO). Duke pasur parasysh këto kufizime, krahasimet midis të dhënave të mbulimit duhet të interpretohen me kujdes (75,76,77).

Faktorët social-strukturorë mund të luajnë një rol të madh në arsyen pse kaq pak age dhe shiringa aksesohen nga PDI në disa pjesë të rajonit. Raportet nga Ukraina për ngacmime të pajustificuara policore jashtë PSHSH-ve dhe klinikave ku administrohet TZO mund të pengojnë shumë PDI që të rikthehen për të marrë age të pastra ose trajtim. Historitë e ndalimit, testimi të detyrueshëm për drogë dhe nënshtrimi të procedurave poshtëruese janë të zakonshme në disa qytete (78). Një studim me metoda të përziara në 3 qytete në Federatën Ruse që përfshin mbi 200 intervista dhe 1500 pyetësorë me PDI raportoi se 93% e injektuesve kishin akses në age/shiringa të pastra nga farmacitë dhe vetëm 7% kishin qenë ndonjëherë në kontakt me PSHSH-të e qytetit (79). Farmacitë u përshkruan si jashtëzakonisht të lehta për t'u aksesuar, ndryshe nga programet, qendrat që mund të jenë larg, dhe kostot e udhëtimit tejkalojnë përfitimin nga marrja falas e pajisjeve dhe rrisin gjasat e ndërhyrjes së policisë. Politikat e shkëmbimit një-për-një në PSHSH u panë gjithashtu si të pa arsyeshme pasi ruajtja dhe transportimi i shiringave të përdorura u përshkrua si i rrezikshëm për sa i përket zbulimit nga një i afërm ose policia si përdorues droge. PSHSH-të shiheshin si të dobishme për marrjen e përfitimeve shtesë si kujdesi shëndetësor dhe një mjedis mbështetës (80).

## **1.4 Meshkujt që kryejnë seks me meshkuj**

Meshkujt që kryejnë seks me meshkuj u referohet të gjithë meshkujve që përfshihen në marrëdhënie seksuale dhe/ose romantike me meshkuj të tjerë. Fjalët "mashkull" dhe "seks" interpretohen ndryshe në kultura dhe shoqëri të ndryshme dhe nga individët e përfshirë. Prandaj, ky term përfshin larminë e madhe të mjediseve dhe konteksteve në të cilat ndodh seksi mashkull me mashkull, pavarësisht nga motivimet e shumta për t'u angazhuar në seks, identitetet e vetëpërcaktuara seksuale dhe gjinore, dhe identifikimet e ndryshme me ndonjë komunitet apo grup të caktuar shoqëror (81).

Epidemitë e HIV-it tek meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj vazhdojnë të zgjerohen në shumicën e vendeve. Në zonat kryesore urbane, prevalenca e HIV-it tek meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkujt është mesatarisht 13 herë më e madhe se në popullatën e përgjithshme (82). Një arsye për prevalencën e lartë të HIV-it tek meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkujt mund të jetë se transmetimi i HIV-it përmes marrëdhënieve anale pa prezervativ është më efikas sesa përmes marrëdhënieve vaginale pa prezervativ, dhe rreziqet në nivel individual për marrjen e HIV-it tek meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkujt përfshijnë marrëdhëniet anale receptive të pambrojtura, numrin e madh të partnerëve meshkuj dhe përdorimin e njëkohshëm të drogës me injektim (83, 84,85).

Meshkujt që kryejnë seks me meshkuj (MSM) janë veçanërisht në rrezik për infeksionin HIV përmes marrëdhënieve seksuale anale të pambrojtura (MAP). Rreziku i përlloritur i marrjes së infeksionit HIV për çdo kontakt nëpërmjet marrëdhënieve seksuale anale të pambrojtura receptive me një partner të njohur HIV pozitiv është 1 në 70 kontakte seksuale për një partner receptiv dhe 1 në 909 kontakte për partnerin insertiv (83). Rreziku i transmetimit për seksin oral është i ulët: një studim e përcaktoi atë të jetë zero; ndërsa një tjetër e llogariti të ishte 1 në 2500 (86).

### **1.4.1 Seksi me pagesë**

Pak të dhëna u gjetën në studimet nga Evropa Perëndimore mbi shpeshtësinë e punës së seksit, megjithatë një studim nga Katalonia, Spanjë zbuloi se 4.1% e të anketuarve kishin paguar për seks (83). Një tjetër studim spanjoll në Valencia, që përfshinte pjesëmarrës nga "apartamentet e punës së seksit", nuk u dha asnjë informacion mbi shpeshtësinë e kësaj praktike, ndërkohë që pjesëmarrësit në studim nga këto apartamente prireshin të ishin më të rinj, migrantë dhe më shumë gjasa të kishin bërë një test HIV sesa grupi i referencës i rekrutuar nga saunat. (84). Në Kroaci, 5% raportuan se kishin shitur ndonjëherë seks (87). Në Izrael, 11% raportuan se kishin paguar për seks (88). Puna e seksit ishte më e zakonshme në një studim në Turqi, 44% kishin shitur seks, si partner insertiv ashtu edhe receptiv, me më shumë se një partner; 37% raportuan se ishin vetëm receptivë dhe 16% atë insertivë (89). Tre studime në Evropën Lindore trajtuan çështjen e seksit me pagesë: 21%

raportuan se kishin shitur seks vitin e kaluar; 16% kishin paguar për seks në 12 muajt e fundit në Federatën Ruse; dhe 21% në Ukrainë në 6 muajt e fundit (90, 91). Marrëdhënia e një mashkulli me punën e seksit mund të ndryshojë me kalimin e kohës, me grupmoshat e reja që shkëmbejnë seksin me ata më të mëdhenj në moshë dhe më të pasur. Një studim cilësor sugjeron se marrja e pagesave në natyrë si pije, qera, akomodim apo dhurata nga partnerët e tyre është praktikë e zakonshme te MSM ballkanike (92). Ky studim zbuloi gjithashtu se aty ku seksi është zakonisht transaksional, praktikat e ndryshimit të partnerit priren të jenë më të larta, një tendencë e cila gjithashtu lidhet në mënyrë të kundërt me moshën në Bullgari, Kosovë, Maqedoninë e Veriu, Rumani, dhe nxori në pah se në raportet seksuale me pagesë mes meshkujve, është blerësi ai që do dikton kushtet e kontaktit seksual, duke përfshirë llojin e aktit seksual; që merr rolin aktiv ose pasiv, dhe përdorimin e prezervativit. Studime të tjera konfirmojnë se vendimet për përdorimin e prezervativit merren nga klientët në Rusi dhe Gjeorgji (93, 94).

#### **1.4.2 Prevalenca e IST te popullata MSM**

Infeksionet seksualisht të transmetueshëm në studime të ndryshme raportohen në mënyra të ndryshme: të marra si nga të dhënat biologjike ashtu edhe nga vetë-raportimi i infeksioneve të fundit dhe të vjetra. Rezultatet e vetë-raportimit mund të kenë probleme të lidhura me mbajtjen mend, ku disa pjesëmarrës kujtojnë detajet e infeksioneve të tyre më saktë se të tjerët, të cilat mund ose nuk mund të lidhen me serostatusin e tyre HIV. Disa IST mund të rrisin ndjeshmërinë e një individi ndaj transmetimit të HIV-it dhe nivelet e larta të IST-ve në një popullatë mund të tregojnë nivele më të larta të rrezikut seksual (përfshirë përdorimin më të ulët të prezervativit) (95). Një studim në Valencia, Spanjë zbuloi se prevalenca e sifilizit në vitin e fundit ishte 4% ndërsa në Katalonjë një studim i bazuar nga të dhënat e vetë-raportuara tregoi se prevalenca e sifilizit ishte 3.3%, gonorrea ishte 4.8% dhe klamidia ishte 2.5% (83,84). Një studim në Mbretërinë e Bashkuar që krahason rastet e reja të diagnostikuara me HIV me kontrollet (të diagnostikuara rishtasi HIV negativ) gjeti prevalencë të lartë të bashkë-infeksionit në rastet me HIV. Bashkë-infeksioni me gonorrenë ishte 27% te rastet dhe 9% në kontrollet, sifilizi ishte shumë më i lartë (7%) te rastet dhe 1% në kontrollet, por klamidia ishte më e ulët te rastet (10%) sesa te kontrollet (19%) (97). Një studim në Kroaci zbuloi se prevalenca e klamidias ishte 9%, sifilizi 10.6%, gonorrea 13.2% dhe HCV 3% (98,99). Në Turqi, një studim zbuloi se prevalenca e sifilisit ishte 10.8%, gonorrea 3%, dhe klamidia 1.8%. Në Lindje, në Azerbajxhan HCV ishte 14% dhe sifilizi 8%, megjithëse metodat e studimit ishin të paqarta (100). Në Gjeorgji, prevalenca e sifilizit ishte 31.4% (35.1% tek ata të moshës nën 25 vjeç dhe 28.9% tek ata mbi 25 vjeç) dhe prevalenca e HCV ishte 15.7% (14% në mesin e atyre nën 25 vjeç dhe 16.9% në grupmoshat më të mëdha) (101). Mbikëqyrja Sentinel në Kazakistan dhe Kirgistan zbuloi se prevalenca e sifilisit ishte përkatësisht 4.1% dhe 10.7%

dhe HCV 4.2% dhe 1.2% respektivisht (102). Një studim te MSM në Moskë, prevalenca e sifilisit ishte 12%, dhe antitruapat ndaj HCV 8% (103).

### **1.4.3 Faktorët që lidhen me HIV**

Janë publikuar një sërë studimesh për faktorët e rrezikut të lidhur me incidencën dhe prevalencën e HIV-it dhe IST-ve në Evropën Perëndimore. Këto studime në shumicën e rasteve janë kryer në zona me prevalencë të lartë të HIV-it te MSM të rekrutuar nga vendet ku ato mbledhen ose klinikat IST, duke kufizuar përgjithësimin e rezultateve në popullatën më të gjerë të MSM-ve. Megjithatë, rezultatet e këtyre studimeve mund të përgjithësohen për mjedise të ngjashme dhe për individë që frekuentojnë mjedise të ngjashme.

Faktorët individualë të rrezikut të lidhur me prevalencën e HIV-it përfshijnë moshën, numrin e partnerëve seksualë, përdorimin e prezervativit, përdorimin e drogës dhe IST. Një studim zviceran i kryer në pesë qytete zbuloi se prevalenca e HIV-it ishte më e ulët tek grupmosha 16-24 vjeç sesa te grupmoshat më të mëdha (25-34 dhe 35-44 vjeç). Një studim në Mbretërinë e Bashkuar që ekzaminoi prevalencën e HIV-it në dy qytete skoceze, zbuloi se moshja më e madhe lidhet me prevalencën e HIV-it. (104).

Studimet nga Holanda (të kryera në një sërë mjedisesh në Rotterdam dhe Amsterdam treguan lidhje jo të qëndrueshme midis incidencës së HIV-it dhe moshës. Studimet nga Amsterdami treguan të njëjtin rrezik në rritje midis grupmoshës 30 deri në 34 vjeç krahasuar me MSM më të rinj, por gjetjet janë të ndryshme për ata të moshës 35 vjeç e lart. Studimi i Roterdamit tregoi ulje të rrezikut në të dy grupmoshat më të mëdha krahasuar me të intervistuarit e moshës nën 30 vjeç. (105, 106)

Disa studime kanë ekzaminuar numrin e partnerëve seksualë si një faktor rreziku, si dhe përdorimin e prezervativit. Në Zvicër, të intervistuarit me 1 ose më pak ose 6 ose më shumë partnerë kishin gjasa më të larta të HIV-it krahasuar me ata që raportuan nga dy deri në pesë partnerë, dhe të paturit e një partneri të njohur HIV pozitiv ka dyfishin e gjasave për HIV. Historia për gonorre dhe në një masë më të vogël, sifiliz shoqërohej me gjasa më të larta të HIV-it (107).

Rreziku i HIV-it ishte më i ulët te MSM që përdornin gjithmonë prezervativë me partnerë të rastësishëm sesa ata që raportuan të kenë përdorur ndonjëherë ose asnjëherë, por rreziku ishte më i lartë krahasuar me ata që nuk raportuan partnerë të rastësishëm. Në Mbretërinë e Bashkuar, nuk u pa asnjë ndryshim midis atyre që kishin më shumë se 10 partnerë seksualë në 12 muajt e fundit dhe atyre që kishin më pak se 10. Numri i partnerëve për marrëdhëniet anale të pambrojtur nuk duket të jetë i lidhur me prevalencën e HIV-it, megjithatë të intervistuarit që raportuan një IST në vitin e kaluar kishin mbi tre herë gjasa për prevalencë të rritur të HIV-it sesa ata pa IST. Marrëdhëniet anale të pambrojtura me më shumë se një partner, partnerë të rastësishëm dhe partnerë me status të panjohur ose



diskordant ishin të gjitha të lidhura në mënyrë të pavarur me gjasa të larta të prevalencës së HIV-it. (104).

#### **1.4.4 Seksi i pambrojtur. Numri i partnerëve seksualë**

Shumë studime janë fokusuar në prevalencën e përdorimit të prezervativit gjatë mardhënieve seskuale anale midis meshkujve. Kjo është matur në mënyra të ndryshme, shpesh të disagreguara sipas një numri karakteristikash që i bëjnë krahasimet midis studimeve të ndryshme komplekse. Shumë studime, duke përfshirë EMIS, e masin përdorimin e prezervativit përmes përqindjes së MSM-ve që raportojnë përdorimin e prezervativit herën e fundit që kishin mardhënie seksuale anale me një mashkull tjetër (i kufizuar në gjashtë muajt e fundit), që korrespondon me një tregues të UNGASS. (108)

Studime të tjera zgjodhën të fokusohen tek pjesëmarrësit që raportnin nëse kishin ndonjë akt të mardhënieve seksuale të pambrojtura brenda një afati kohor të caktuar; në përgjithësi gjashtë muaj, por variojnë nga një deri në 24 muaj. Të dyja qasjet kanë avantazhe dhe disavantazhe: indikatorët që mbulojnë periudha më të gjata kohore mund të jenë më përfaqësuese të praktikave të përgjithshme të rrezikut të një individi, megjithatë kjo mund të jetë subjekt i gabimeve në raportim që lidhen me kujtesën, kështu që përdorimi i prezervativit herën e fundit të kryerjes së mardhënieve seksuale anale mund të jetë një tregues më i vlefshëm. Gjetjet e studimit EMIS tregojnë se përdorimi më i lartë i prezervativit haset në Perëndim, rreth 15% më shumë se përdorimi i raportuar në lindje të rajonit. Përqindja minimale e raportuar në Perëndim ishte 41% (Suedi), Europën Qëndrore 6% (Maqedoni e Veriut) dhe 37% në Lindje (Bjellorusi). Përqindjet më të larta të raportuara ishin 69% në Perëndim (Greqi), 60% në Qendër dhe 58% në Lindje (Ukrainë). Në përgjithësi, ka pak ndryshim në përdorimin e kondomit herën e fundit të kryerjes së mardhënieve seskuale anale me një mashkull tjetër midis atyre të moshës nën dhe mbi 25 vjeç, megjithëse në Qendër duket se MSM më të rinj kanë më pak gjasa të raportojnë përdorimin e prezervativit sesa homologët e tyre më të rritur. Shumë studime kanë mbledhur të dhëna për numrin e partnerëve seksualë. Ndërsa kornizat kohore prej gjashtë ose 12 muajsh përdoren përgjithësisht, ka shumë ndryshime në klasifikimin dhe kuantifikimin e partnerëve. Ndërsa kjo e bën krahasimin shumë të vështirë, është konstatuar se aty ku raportohen të dyja të dhënat, mesataret janë përgjithësisht më të larta se mesoret, duke treguar se ndërsa shumica e të intervistuarve mund të raportojnë një numër mjaft të vogël partnerësh, një pakicë raporton numra shumë të mëdhenj (109, 110).

#### **1.4.5 Faktorët të lidhur me seksin të pambrojtur**

Disa studime që shqyrtojnë faktorët e rrezikut të lidhur me marrëdhëniet seksuale të pambrojtura të matura nga përdorimi i raportuar i prezervativit në marrëdhënien e fundit

seksuale anale ose mardhëniet e pambrojtura anale të raportuara u identifikuan nga një rishikimi sistematik (111).

Faktorët individualë të rrezikut të lidhur me seksin anal të pambrojtur te MSM-ve në rajon përfshijnë: llojet dhe numrin e partnerëve; përdorimi i drogës; historia e testimit për HIV; disponueshmëria e prezervativit; dhe statusi HIV. Studimet nga Mbretëria e Bashkuar dhe Zvicra sugjerojnë se të personat HIV negativ dhe ata që nuk kanë kryer një test kanë më pak gjasa të raportojnë seks anal të pambrojtur sesa ata HIV pozitiv (113,114). Një studim spanjoll i fokusuar tek meshkujt me partnerë të rregullt zbuloi se çiftet serodiskordantë ose HIV pozitivë kishin më pak gjasa të praktikonin mardhënie seksuale anale të pambrojtura sesa çiftet HIV-negative (115).

Ndonëse të dhënat nga Izraeli treguan se meshkujt me partner të rastësishëm ose të qëndrueshëm dhe të rastësishëm kishin gjasa më të larta për të raportuar seks anal të pambrojtur, një studim francez te personat HIV pozitiv raportoi se ata që kishin marrëdhënie seksuale me një partner të rastësishëm gjatë një lidhjeje kishin gjasa më të ulëta të raportimit të seksit anal të pambrojtur. Edhe pse lidhja midis numrit të partnerëve dhe seksit anal të pambrojtur është e paqartë, studimet që tregojnë modele të veçanta sipas serostatusit tregojnë se të intervistuarit HIV pozitiv me një numër më të madh partnerësh kanë gjasa më të larta për të raportuar mardhënie të pambrojtura sesa ata HIV negativ me numra të ngjashëm partnerësh (116).

## **1.5 Punonjëset e seksit**

Në shumë vende të botës, prevalenca e infeksionit HIV është dokumentuar të jetë më e lartë në në popullatën e punonjëseve të seksit (PS) sesa në në pjesën tjetër të popullatës. Kjo vërehet tek punonjësit e seksit meshkuj dhe transgjinorë. Te gratë vërehet një numër gjithnjë në rritje i infeksioneve me HIV në nivel global (117). Një shqetësim i veçantë mbetet rritja e numrit të rasteve me HIV tek femrat e reja. Faktorët e njohur për rritjen e vulnerabilitetit të punonjëseve të seksit femra ndaj infeksionit HIV janë mungesa e politikave dhe legjislacionit mbrojtës, informacioni i kufizuar, mungesa e aksesit në shërbime si dhe faktorët e stilit të jetesës (118).

Në të gjithë rajonin europian, femrat që punojnë në industrinë e seksit janë kryesisht të moshës ndërmjet 20 dhe 30 vjeç. Moshë mesatare ose mediane e punonjëseve të seksit në Londër, Milano, Katalonjë dhe Izrael varion nga 20 deri në 30 vjeç (119,120,121,122,123). Të dhënat nga Lindja sugjerojnë se punonjëset e seksit femra që uhtrojnë aktivitetin e tyre ne rruge janë më të reja, me një moshë mesatare që varion nga 21 deri në 27 vjeç (114,125).

Ka një numër në rritje të provave që demonstrojnë lidhjen midis rrezikut për HIV dhe ekspozimin ndaj dhunës të punonjëseve të seksit (126,127). Ndërveprimi i dhunës dhe HIV-it midis punonjëseve të seksit ka faktorë të drejtpërdrejtë si seksi i detyruar i

pambrojtur, si dhe indirektë si ulja e vetëvlerësimit dhe aftësia për të negociuar praktika më të sigurta nga frika e dhunës së mëtejshme; rritja e përdorimit të drogës ose zhvendosja e detyruar e punës së seksit në zona më pak të njohura ose të sigurta. (128,129,130) Të dhënat nga Evropa tregojnë se nivelet e dhunës seksuale dhe fizike midis punonjëseve të seksit femra ishin të larta, e në mënyrë të veçantë te popullata rome dhe transvestitët (131). Të dhënat cilësore nga Evropa Perëndimore sugjerojnë se dhuna ndaj punonjëseve të seksit është e pranishme kudo dhe e ndërthurur me përdorimin e drogës dhe stigmën e lidhur me punën e seksit (131,132, 133).

### **1.5.1 Sjelljet e rrezikshme seksuale**

Disa studime dëshmojnë rritje të rrezikut të lidhura me sjelljet seksuale gjatë punës së seksit. Në Spanjë rreziku i klamidias dhe gonorresë ishte më i lartë te PS që kryen mardhënie seksuale të pambrojtura me klientët (28) dhe rreziku i infeksionit me gonorre, klamidia ose sifiliz aktiv ose bashkë-infeksionit ishte më i lartë te ato që raportonin më shumë se 30 klientë në javë dhe që nuk përdornin rregullisht prezervativ gjatë mardhënieve seksuale (134).

Të dhënat sugjerojnë ndërveprimin midis përdorimit të drogës dhe punës së seksit në përdorimin e prezervativëve: punonjëset e seksit që përdorin drogë kanë më pak gjasa të përdorin prezervativë sesa ato që nuk injektojnë. Përdoruesit e drogës me injektim që shesin seks kanë më pak gjasa të përdorin prezervativë sesa ato që nuk janë të angazhuar në punën e seksit (135,136).

## **1.6 Survejanca te popullata kyç**

### **1.6.1 Vlerësimi i prevalencës së HIV dhe sjelljes së rrezikut**

Për të kuptuar dinamikën e epidemive të HIV-it në popullatat kyç, duke përfshirë infeksionet e padiagnostikuara, është e rëndësishme të vlerësohet drejtpërdrejt prevalenca e HIV-it dhe niveli i sjelljeve të rrezikshme. Sipas udhëzimeve të OBSH-së për survejancën e gjeneratës së dytë të HIV-it, studimet për të vlerësuar drejtpërdrejt prevalencën dhe rrezikun e HIV-it duhet të ndërmerren periodikisht në të gjitha vendet dhe rregullisht në vendet me epidemi të përqendruara (137).

Në mungesë të një kornize përfaqësuese të kampionimit, një faktor kryesor kur vlerësohet prevalenca e HIV-it në popullatat kyç është strategjia e rekrutimit dhe kampionimit. Strategjitë e kampionimit që rekrutojnë nga zona dhe rrjete të ndryshme do të minimizojnë gabimet sistematike të lidhura me shpërndarjen gjeografike dhe rrjetin e anëtarëve të popullatave kyç. Nga ana tjetër, studimet që rekrutojnë pjesmarrës nga një numër i madh vendndodhjesh mund të pretendojnë një përgjithësim të rezultateve të tyre krahasuar me ato që rekrutojnë vetëm nga një ose dy vendndodhje (138,139). Në studime të veçanta ku

pjesmarrësit rekrutohen vetëm nga mjediset klinike, kampioni i përzgjedhur anon nga individët me rrezik më të lartë ose atyre që kanë akses dhe të përdorin shërbimet e testimit ose trajtimit. Provat sugjerojnë se përdoruesit e drogës në trajtim ndryshojnë sistematikisht nga ata që nuk trajtohen aktualisht. (140,141,142) Marrja e mostrave të PDI nga shërbimet e TZO, nuk përfshijnë grupe të tjera injektuesish me karakteristika dhe rreziqe të ndryshme (143).

Studimet e survejancës së shëndetit publik zakonisht përdorin qasje pragmatike për të siguruar përdorim efikas të burimeve të disponueshme, për të lejuar që të dhënat të mbledhen dhe të vihen në dispozicion relativisht shpejt dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre me kalimin e kohës. Kështu, studimet duhet të balancojnë besueshmërinë (d.m.th., përfaqësimin dhe mbulimin gjeografik) kundrejt përdorimit efikas të burimeve, afatit kohor dhe qëndrueshmërisë, si dhe duke marrë parasysh kontekstin e popullatës në studim. Kjo nevojë për një qasje pragmatike shpesh çon në studime që përdorin qendrat sentinel dhe nëngrupe të aksesueshme të popullatës për të prodhuar të dhëna që mund të japin një panoramë nivel kombëtar kur kombinohen me të dhëna të tjera të disponueshme (p.sh. numrin e rasteve të HIV-it, të dhënat për testimin për HIV, të dhënat e përdorimit të shërbimeve, dhe vlerësimet e madhësisë së popullatave kyc (144,145).

### **1.6.2 Matja e madhësisë së popullatave për MSM , PDI dhe PS**

Njohja e madhësisë së popullatave kyç është e rëndësishme për planifikimin e shërbimeve të parandalimit dhe kujdesit ndaj HIV-it, si dhe për vlerësimin e dëmit që lidhet me popullatat ose sjelljet e rrezikshme. Pa një emërues është e vështirë të vlerësohet nëse prevalenca e HIV-it po rritet dhe/ose nëse madhësia e grupit të popullatës po rritet. Ndërsa pothuajse të gjitha vendet kanë të dhëna për madhësinë e popullsisë së të përgjithshme, matja e madhësisë së grupeve me rrezik të lartë nuk është një aktivitet demografik rutinë pjesërisht për shkak të sfidave të lidhura arritjen e këtyre popullatave. Për shkak të natyrës së paligjshme dhe të margjinalizuar të përdorimit të drogës me injektim dhe punës seksit, dhe diskriminimit të zakonshëm ndaj MSM-ve, madhësia e këtyre grupeve është e vështirë të vlerësohet. Në rastin e punonjëseve të seksit, problemet e vlerësimit ndërlikohen më tej nga natyra e lëvizshme e grupit. Vlerësimet e madhësisë së popullsisë së këtyre grupeve zakonisht përdorin metoda të tërthorta të vlerësimit, si metodat e kapjes-rikapjes dhe të efektit shumëzues. Një numër vendesh janë përpjekur të bëjnë një vlerësim të tillë nëpërmjet matjes së sjelljeve në popullatën e përgjithshme, megjithatë, besueshmëria e kësaj metode është e paqartë (146,147)

Vlerësimet e PDI-ve dhe punonjëseve të seksit zakonisht kanë të bëjnë me individë që kanë injektuar drogë ose kanë shitur seks së fundmi (p.sh., injektuar në muajin e kaluar, ose të shitur seks vitin e kaluar). Vlerësimet e MSM-ve mund të lidhen me sjelljen seksuale,

(p.sh., ka pasur marrëdhënie seksuale me një mashkull tjetër në vitin e fundit), ose identitetin (p.sh., identifikimi si homoseksual ose biseksual) (148)

## **1.7 Të dhënat epidemiologjike të HIV/AIDS Shqipëri**

Të dhënat ekzistuese dëshmojnë se në Shqipëri nuk ka epidemi të gjeneralizuar apo të përqendruar të infeksionit HIV. Ndërsa numri vjetor i rasteve të raportuara mbeti nën 50 raste deri në vitin 2010, midis vitit 2010 dhe 2022 numri vjetor i rasteve të raportuara me HIV u rrit më shumë se 2 herë nga 48 raste (2008) në 127 raste (4.5 raste/100.000 që ishte niveli më i lartë) në 2016. Numri i rasteve të reja të diagnostikuara në 2022 është 80, ndërsa referuar të dhënave kumulative, gjatë periudhës 1993-2022, numri total i rasteve të raportuara me HIV/AIDS është 1586. Në fund të Tetorit 2022, prevalenca e infeksionit vlerësohet të jetë me 0,06%, ndërsa incidenca (rastet e reja në 2022) 2.9 për 100,000 banorë. Gjatë periudhës së parë të infeksionit HIV në Shqipëri (1993-2000) numri mesatar i rasteve të raportuar ishte 6-7 persona në vit ; në vitet 2001- 2003 vihet re një dyfishim i numrit të rasteve, mesatarisht 20 raste të reja të diagnostikuara në vit ; në periudhën 2004-2010 kjo shifër ka kaluar numrin 30; pas vitit 2010 shifra e rasteve të reja pothuajse është dyfishuar (149).

Rruga seksuale e transmetimit të virusit HIV vazhdon të dominojë në vendin tonë, e cila konstatohet në afërsisht 96% të rasteve. Sipas të dhënave kumulative (deri në Tetor 2022) transmetimi heteroseksual përbën 83.7% të rasteve, ndërkohë që mënyra e transmetimit nëpërmjet marrëdhënieve seksuale midis meshkujve haset në 12.2 % të rasteve. Transmetimi vertikal ose nga nëna e infektuar me HIV te fëmija përbën 2.5 % të totalit (39 raste) 0.7% i perkasin rasteve te transmetimit nepermjet gjakut apo nenprodukteve te tij; 0.5% e rasteve i perkasin grupit të Personave që Injektojnë Drogë dhe në 0.4 % të numrit total të rasteve pozitive, rruga e transmetimit mbetet e papërcaktuar (149).

## **1.8 Popullatat Kyç në Shqipëri**

### **1.8.1 Vlerësimi i madhësisë së popullatave kyç**

Përdoruesit e drogave me injektim (PDI) dhe meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj (MSM) janë popullatat kryesore më të mëdha të vlerësuara në Shqipëri me rreth 7,000 individë të shpërndarë në të gjitha prefekturat. MSM janë një popullatë kyçe shumë e fshehur për shkak të stigmës dhe diskriminimit të përgjithshëm. Të dy, MSM dhe punonjëset e seksit (PS) janë më të dukshëm në Tiranë (151). Shifrat e vlerësuara të popullatave kyçe të ndryshme janë paraqitur në më poshtë (Tabela 1).

**Tabela 1: Përmbledhje e vlerësimeve rajonale dhe kombëtare për Personat që Injektojnë Drogë, Meshkujt që kryejnë seks me Meshkuj, dhe Punonjëseve Femra të Seksit**

Rrethi	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi
Elbasan	630	720	170
Berat	550	360	90
Durrës	710	360	280
Tirana	940	2,270	810
Dibër	480	340	50
Kukës	480	200	40
Lezhë	480	330	100
Shkodër	510	500	140
Fier	520	780	180
Gjirokastrë	480	190	50
Korçë	580	570	130
Vlorë	610	440	160
<b>Shqipëri</b>	<b>6,970</b>	<b>7,060</b>	<b>2,200</b>

Vlerësimi i madhësisë për MSM-ve në Shqipëri rezultoi në një përqindje më të ulët të popullsisë së rritur (<0,5%). Në shumicën e vendeve evropiane, madhësia e popullsisë MSM është vlerësuar midis 1-3% të popullsisë së rritur.

Raportimi i ulët i preferencave seksuale është pasojë e nivelit të lartë të stigmës dhe diskriminimit në komunitet. Faktorët socialë, kulturorë, politikë dhe ekonomikë siç janë nivelet e larta të diskriminimit shoqëror dhe dukshmëria e popullatës së MSM-ve i parandalojnë njerëzit që të lidhen me njëri-tjetrin dhe zvogëlojnë mundësinë e tyre për t'u përfshirë në këto vlerësime. Si efekt kolateral negativ, padukshmëria e MSM-ve dhe komuniteteve të tjera të popullatave kyç bëhet pengesë për një përgjigje efektive ndaj epidemisë së HIV. Prandaj, është urgjente të trajtohet stigmatizimi, diskriminimi dhe homofobia në mënyrë që të rritet aksesimi për atë grup të MSM-ve që mund të shmangin sistemin shëndetësor (151).

### **1.8.2 Përdoruesit e Drogave me Injektiv (PDI)**

Një hartëzim programatik i popullatave kyç tregoi se PDI janë popullata më e madhe në Shqipëri. Përqindja më e lartë e PDI-ve e injektojnë drogën zakonisht në vendet/shtëpitë e braktisura, hapësirat e hapura, rrugët, parqet etj. Kjo më së shumti ndodh gjatë kohës kur këto vende nuk frekuentohen dhe prandaj PDI nuk janë një grup i dukshëm. Injektivet zakonisht merren gjatë orëve të para të mëngjesit 05:00 - 11:00 dhe pasdite sa ka dritë. Një pjesë e vogël e PDI e bëjnë injektimin e drogës nëpër shtëpitë e tyre dhe më shpesh nëpër vende të fshehta (151).

Nje studimi biologjik dhe i sjelljes i kryer në Tirane në vitin 2011, zbuloi nje rast me HIV në këtë popullatë, ndërkohë që prevalenca e Hepatitit C rezultoi 29%. Përsa i përket sjelljeve te rrezikshme te PDI-ve, gjatë muajit te kaluar, pjesa më e madhe e tyre (43.5%) kanë injektuar drogë disa herë në dite, ku heroina përmendet si droga më shpesh e injektuar. Pavarësisht nga njohuritë se përdorimi i shiringave të përdorura më parë mund të transmetojë HIV-in dhe se shiringat e pastra janë te disponueshme në farmaci, 40.5% e PDI-ve kanë ndarë shiringat dhe akoma më shume prej tyre kanë ndarë pajisjet per injektimin e drogës. Përveç sjelljeve të riskut të shoqëruara me injektimin, popullata e PDI-ve përfshihet gjithashtu në sjellje risku të shoqëruara me praktikat seksuale që ata aplikojnë. Më shume sesa gjysma e tyre te cilët janë seksualisht aktiv, kanë patur dy ose më shumë partnerw vitin e kaluar. Partneret ishin kryesisht të rregullt ose jo të rregullt (jo me pagesë) dhe përdorimi i vazhdueshëm i prezervativit ishte i ulët, vetëm 8.5% me partner të rregullt dhe 12.6 % me partner jo të rregullt. Ndërkohe që PDI janë të ndërgjegjshëm për infeksionet që transmetohen seksualisht, pak ishin të aftë te përshkruanin simptomat e IST-ve. Këto sjellje risku te lidhura me prevalencën e lartë të Hepatitit C, ilustronje vulnerabilitetin e PDI-ve ndaj HIV-it (152)

### **1.8.3 Meshkuj që kryejnë seks me meshkuj (MSM)**

Një raport i fundit për shëndetin në Evropë raportoi se meshkujt janë rreth tre herë më shumë të predispozuar të diagnostikohen me HIV sesa gratë. Rreth 40% e transmetimit të ri të HIV-it bëhet nëpërmjet meshkujve që kryejnë seks me meshkuj dhe 32% nëpërmjet kontaktit heteroseksual, ndërsa 4% e rasteve të reja nëpërmjet injektimit të drogës (153). Në Shqipëri, ndërsa shumica e rasteve të HIV-it supozohet se janë marrë në rrugë heteroseksuale - siç u përmend më lart - raporti më shumë se 2-me-1 i diagnozave ndërmjet mashkujve dhe femrave tregon se mund të ketë nën-raportim të konsiderueshëm të infeksioneve të marra nëpërmjet marrëdhënieve seksuale ndërmjet meshkujve.

Hartëzimi programatik i popullatave kyç tregoi se meshkujt që kryejnë seks me meshkuj në Shqipëri janë popullata kyçe më shumë e fshehur, përveç Tiranës, kështu që aktivitetet e MSM-ve në Shqipëri në përgjithësi nuk janë shumë të dukshme për shkak të stigmës dhe diskriminimit të përgjithshëm që përjeton kjo popullatë kyçe. Shumë më pak MSM operojnë në pika gjeografike të njohura, për shkak të stigmës dhe diskriminimit të madh ndaj marrëdhënieve të të njëjtit seks dhe si rezultat i dëshirës së komunitetit për të mbajtur të fshehta veprimet dhe aktivitetet e tyre seksuale, një pjesë më e madhe e aktivitetit të MSM-ve ndodh virtualisht. Ky është informacion i rëndësishëm, i cili duhet të përdoret nga programet e parandalimit pasi një numër më i madh MSM veprojnë përmes rrjeteve të fshehura dhe kanë aktivitete të fshehta, dhe ndërhyrja e synuar për këtë komunitet specifik do të ketë nevojë për një qasje mjaft të ndryshme në krahasim me qasjet parandaluese për punonjësit e seksit ose PDI (151).

Një studimi vitit 2011 në Tiranë tregoi se në përgjithësi, kombinimi i faktorëve të riskut të MSM –ve – përfshirja në seks të pambrojtur me meshkuj dhe femra, dhe injektimi i drogave e bën thelbësore ndërhyrjen apo targetimin e këtij grupi si pjesë e një strategjie për parandalimin e HIV-it në Shqipëri. Nderkohë që nivelet e prevalencës së HIV-it ishin të ulta (0.5%), studimi nuk ka përfshirë informacionin rreth IST-ve akute, të cilat mund të siguronin veshtrim më të thellë në lidhjet që ekzistojnë ndërmjet sjelljeve të rrezikshme dhe shfaqjes së infeksioneve. Popullata e MSM-ve është e përfshirë në sjellje të ndryshme të rrezikshme me popullatën e ndryshme, duke i bërë ata një urë lidhëse të mundshme ndërmjet popullatës që është përdoruese e drogës dhe popullatës femerore, në lidhje me transmetimin e IST-ve (152)

#### **1.8.4 Punonjëset e seksit**

Punonjëset e seksit janë një nga grupet më të vështira për tu identifikuar dhe programet e parandalimit për këtë popullatë vazhdojnë të jenë të kufizuara. Në Shqipëri seksi me pagesë ndalohet me ligj, çka bën që ai të ushtrohet në mënyrë të paligjshme. Ekzistojnë pak të dhëna për punonjëset e seksit në Shqipëri. Është e qartë se ky grup i popullatës është në pozita të pambrojtura, sepse nuk dihet sjellja e tyre, mënyra si ushtrojnë aktivitetet, sa janë dhe çfarë gjendje shëndetësore kanë. Kjo i vë ato në një pozitë të lartë rrisht të infektimit me HIV. Gjithashtu klientët e tyre janë të rrezikuar.

Mund të dallohen dy tipe të punonjësve të seksit: ata që qëndrojnë në rrugë dhe ata në motel/hotel/apartament. Puna seksuale në rrugë është më e dukshme dhe përfaqësohet nga grupet më të pafavorizuara, të cilat përballen me dhunë, diskriminim dhe veprime policore, ndërkohë që nuk kanë qasje në shërbime të duhura sociale dhe shëndetësore (155).

Një ushtrim hartëzimi nga UNFPA në vitin 2009 identifikoi vështirësitë e punës me punonjësit e seksit: ata janë të stigmatizuar dhe të diskriminuar, është e vështirë të arrihen direkt, pasi ata punojnë nëpërmjet ndërmjetësve (tutorëve, shoferëve të taksisë, hoteleve/moteleve). Shumë përdorin telefona celularë ose internet për të gjetur klientë. Ekzistojnë dëshmi jozyrtare të studenteve që merren me punë seksi gjatë kohës së tyre në universitet. Shitja e seksit është shumë e stigmatizuar dhe grupi i punonjësve të seksit që njohin dhe mbështesin njëri-tjetrin është shumë i vogël, në rreth tre, gjë që e bën ndikimin e ndërhyrjes të kufizuar (153).

Rezultatet e studimit tëurvejancës së integruar të bio-sjelljes të vitit 2011 (IBBS) zbuluan se rreth një e treta e të anketuarve kishin filluar të angazhohen në punë seksuale rreth moshës 18 vjeç. Ndërsa shumica e tyre deklaruan se përdorin prezervativ, përdorimi i rregullt i prezervativit ishte i kufizuar; afërsisht një e katërta e të anketuarave deklaroi se nuk kishin përdorur prezervativ gjatë marrëdhënies seksuale të fundit me një klient. Një e katërta e punonjësve të seksit raportuan se përdornin drogë, me gati 8% që kishin marrë



drogë me injektim të paktën një herë në 12 muajt e fundit; më shumë se gjysma e këtyre grave janë me origjinë rome (152).

Hartëzimi i fundit (2019) i përmendur më lart zbuloi një informacion më të thelluar cilësor mbi strukturën, tipologjinë dhe dinamikën operative të punës së seksit. Ka disa tipologji të përfshira, secila ka dinamikën e vet funksionale dhe nevojat e parandalimit. Puna seksuale në Shqipëri është e organizuar me rreth pesë lloje të ndryshme vendesh, ku punonjëset seksuale femra mblidhen, gjejnë partnerë seksualë ose përfshihen në aktivitete seksuale. Më shumë se një e treta frekuentojnë vende të hapura/stacione autobusi dhe parqe. Shërbimet seksuale nuk ofrohen vetëm në këto vende. Ekzistojnë dëshmi se shumë të rinj, ose të ashtuquajtur punonjës seksi "të klasës së mesme" si studentë dhe nxënës të shkollës së mesme janë aktive në rrjetet sociale, të cilat nuk janë të dukshme, por tejet të fshehura (151).

### **1.8.5 Popullata rome**

Niveli i ulët i njohurive dhe i perceptimit të rrezikut ndaj HIV/AIDS është i shpeshtë në popullatën Rome. Kjo lidhet me përqindjen e lartë të braktisjes së shkollës nga femijet dhe të rinjtë Romë, si dhe me shkaqet që hasen dhe në grupet e tjera të popullatës. Niveli i ulët i sjelljeve seksuale të sigurta lidhet me mungesën e njohurive dhe informacionit. Burimet kryesore të informacionit për HIV/AIDS, ashtu si dhe në grupet e tjera me rrezik, mbeten media dhe bashkëmoshataret, ndërsa shkolla dhe familja konsiderohen si burime më pak të rëndësishme. Sidoqoftë, faktorët socio-ekonomikë dhe kulturorë e bëjnë komunitetin rom më të cenueshëm prej sëmundjeve seksuale dhe infeksioni HIV. Një studim i vitit 2008 në Tiranë vlerëson se marrëdhëniet e para seksuale në popullsinë rome kryhen midis moshës 10-14 vjeç (24% ) dhe 84% deklarojnë të kenë kryer marrëdhënien e parë seksuale para moshës 18 vjeç. Fillimi i hershëm i marrëdhënieve seksuale dhe rreziku pasues më i lartë për HIV dhe IST-të lidhet me mosvijimin e shkollës dhe mosekspozimin ndaj programeve të parandalimit në shkollë. Femrat janë më të predispozuar të bëjnë seks në moshë të re dhe një në pesë gra rome (21,3%) detyrohet nga partneri të kryejë marrëdhënie kundër dëshirës (152).

## **KAPITULLI II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT**

### **2.1 Qëllimi i studimit**

Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi është vlerësimi i prevalencës së sjelljeve të rrezikshme të lidhura me infeksionin HIV, vulnerabilitetin ndaj HIV-it, mbulimin me shërbime parandaluese të popullatave kyç, dhe fuqizimi i sistemit kombëtar të survejancës të gjeneratës së dytë për monitorimin e prevalencës dhe sjelljeve të lidhura me infeksionin HIV.

### **2.2 Objektivat e studimit**

#### **2.2.1 Objektivi i përgjithshëm 1**

Të përcaktohet prevalenca e sjelljeve të rrezikshme të lidhura me infeksionin HIV të popullatave kyç.

##### **2.2.1.1 Objektivat specifike për objektivin e përgjithshëm 1**

- Të përcaktohet moshë mesatare dhe kohëzgjatja mesatare e përdorimit dhe injektimit të drogave të PDI
- Të përcaktohen drogat më shpesh të përdorura dhe injektuara të PDI
- Të llogaritet shpeshtësia e injektimit të drogës të PDI
- Të përcaktohet përdorimi i ageve/shiringave të përdoruar në injektimin e fundit të drogës të PDI
- Të përcaktohet shkëmbimi i ageve/shiringave në muajin e fundit të PDI
- Të përcaktohet shpeshtësia dhe mënyra e pastrimit të ageve/shiringave të PDI
- Të përcaktohet shpeshtësia e shkëmbimit të pajisjeve të injektimit në muajin e fundit të PDI
- Të përcaktohet përdorimi i alkoolit dhe drogës të MSM
- Të përshkruhet sjellja seksuale dhe përcaktohet përdorimi i prezervativit me partnerët me pagesë të MSM
- Të përshkruhet sjellja seksuale dhe përcaktohet përdorimi i prezervativit me partnerët jo të rregullt, pa pagesë të MSM
- Të përshkruhet sjellja seksuale dhe përcaktohet përdorimi i prezervativit me partnerët të rregullt të MSM

- Të përcaktohet sjellja seksuale dhe përdorimi i prezervativit me partneret seksuale femra te MSM
- Të përcaktohet sjellja seksuale dhe përdorimi i prezervativit te popullata rome

## **2.2.2 Objektivi i përgjithshëm 2**

Të vlerësohet aksesimi dhe përdorimi i shërbimeve të trajtimit dhe parandalimit te popullatat kyç.

### **2.2.2.1 Objektivat specifike për objektivin e përgjithshëm 2**

- Të përcaktohet përdorimi i shërbimeve të trajtimit për drogën te PDI
- Të përcaktohen lloji i trajtimit dhe ndihmës së marrë te PDI
- Të përcaktohet aksesimi në programet e shkëmbimit të shiringave te PDI
- Të përcaktohet ofrimi i këshillimit për përdorimin e prezervativit dhe seksin e sigurtë në 6 muajt e fundit (nëpërmjet një shërbimi në terren, qendër drop-in) te PDI
- Të përcaktohet kontakti me edukator bashkëmoshatar ose punonjës terreni te PDI
- Të përcaktohet aksesimi në shërbimet e testimit për infeksione seksualisht të transmetueshme te PDI
- Të përcaktohet niveli i testimit për HIV te PDI
- Të përcaktohet ofrimi i këshillimit për përdorimin e prezervativit dhe seksin e sigurtë në 6 muajt e fundit (nëpërmjet një shërbimi në terren, qendër drop-in) te MSM
- Të përcaktohet kontakti me edukator bashkëmoshatar ose punonjës terreni te MSM
- Të përcaktohet aksesimi në shërbimet e testimit për infeksione seksualisht të transmetueshme te MSM
- Të përcaktohet niveli i testimit për HIV te MSM

### **2.2.3 Objektivi i përgjithshëm 3**

Të vlerësohet niveli i njohurive për HIV dhe IST te popullatat kyç

#### **2.2.3.1 Objektivat specifikë për objektivin e përgjithshëm 3**

- Të përcaktohet niveli i njohurive lidhur me mënyrat e transmetimit të HIV te PDI
- Të përcaktohet niveli i keqkuptimeve të lidhura me transmetimin e HIV te PDI
- Të përcaktohen njohuritë dhe sjelljet e testimit për HIV te PDI
- Të përcaktohet niveli i njohurive lidhur me mënyrat e transmetimit të HIV te MSM
- Të përcaktohet niveli i keqkuptimeve të lidhura me transmetimin e HIV te MSM
- Të përcaktohen njohuritë dhe sjelljet e testimit për HIV te MSM
- Të përcaktohet niveli i njohurive lidhur me mënyrat e transmetimit të HIV te popullata rome
- Të përcaktohet niveli i keqkuptimeve të lidhura me transmetimin e HIV te popullata rome
- Të përcaktohen njohuritë dhe sjelljet e testimit për HIV te popullata rome

### **2.2.4 Objektivi i përgjithshëm 4**

Të vlerësohet niveli i stigmës dhe diskriminimit te popullatat kyç

#### **2.2.4.1 Objektivat specifikë për objektivin e përgjithshëm 4**

- Të përcaktohet niveli i stigmës dhe diskriminimit ndaj personave që jetojnë me HIV/AIDS te PDI
- Të përcaktohet shmangia e kërkimit të shërbimeve shëndetësore dhe testimit për HIV te PDI
- Të përcaktohet shmangia e kërkimit të testimit për HIV te PDI
- Të përcaktohet niveli i fenomeneve të ngacimit, lëndimit apo arrestimit për shkak të injektimit të drogës te PDI
- Të përcaktohet niveli i stigmës dhe diskriminimit ndaj personave që jetojnë me HIV te MSM

- Të përcaktohet shmangia e kërkimit të shërbimeve shëndetësore dhe testimit për HIV te MSM
- Të përcaktohet shmangia e kërkimit të testimit për HIV te MSM
- Të përcaktohet niveli i fenomeneve të ngacmimit, lëndimit apo arrestimit për shkak të të qënit MSM
- Të përcaktohet niveli i stigmës dhe diskriminimit ndaj personave që jetojnë me HIV te popullata rome

## **2.2.5 Objektivi i përgjithshëm 5**

Të përcaktohet prevalenca e infeksionit HIV, Hepatitit C dhe Sifilizit popullatat kyç

### **2.2.5.1 Objektivat specifike për objektivin e përgjithshëm 4**

- Të përcaktohet prevalenca e HIV te PDI
- Të përcaktohet prevalenca e Hepatitit C te PDI
- Të përcaktohet prevalenca e sifilizit te PDI
- Të përcaktohet prevalenca e HIV te MSM
- Të përcaktohet prevalenca e Hepatitit C te MSM
- Të përcaktohet prevalenca e sifilizit te MSM
- Të përcaktohet prevalenca e HIV te popullata rome
- Të përcaktohet prevalenca e sifilizit te popullata rome

## **2.3 Hipotezat e studimit**

Hipotezat e zeros së studimit aktual renditen në vijim:

1. Nuk ka lidhje midis kohëzgjatjes së injektimit të drogës dhe grupmohës të PDI-ve
2. Nuk ka lidhje midis injektimit me age/shiringë të përdorur në muajin e fundit dhe grupmohës të PDI-ve

3. Nuk ka lidhje midis shkëmbimit të shiringave në muajin e fundit dhe grupmoshës të PDI-ve
4. Nuk ka lidhje midis ndarjes së enëve të përgatitjes, pajisjeve të injektimit dhe grupmoshës të PDI-ve
5. Nuk ka lidhje midis marrjes së drogës nga një enë e përbashkët në muajin e fundit dhe grupmoshës të PDI-ve
6. Nuk ka lidhje midis trajtimit për droga dhe grupmoshës të PDI-ve
7. Nuk ka lidhje midis marrjes së ageve/shiringave të pastra nga OJQ dhe grupmoshës të PDI-ve
8. Nuk ka lidhje midis informacionit të marrë nga një punonjës terreni në lidhje me infeksionin HIV dhe grupmoshës të PDI-ve
9. Nuk ka lidhje midis informacionit për IST dhe grupmoshës të PDI-ve
10. Nuk ka lidhje midis testimit për HIV dhe grupmoshës të PDI-ve
11. Nuk ka lidhje midis Hepatitit C dhe karakteristikave socio-demografike të PDI-ve
12. Nuk ka lidhje midis Hepatitit C dhe sjelljeve të lidhura me injektimin drogës të PDI-ve
13. Nuk ka lidhje midis Hepatitit C dhe aksesit në shërbime të PDI-ve
14. Nuk ka lidhje midis shkëmbimit të shiringave në muajin e fundit dhe karakteristikave socio-demografike të PDI-ve
15. Nuk ka lidhje midis shkëmbimit të shiringave në muajin e fundit dhe trajtimit për problemet e drogës te PDI
16. Nuk ka lidhje midis shkëmbimit të shiringave në muajin e fundit dhe aksesit në shërbime të PDI-ve
17. Nuk ka lidhje midis informacionit të marrë nga një punonjës terreni në lidhje me infeksionin HIV dhe grupmoshës të MSM-ve
18. Nuk ka lidhje midis informacionit për IST dhe grupmoshës të MSM-ve
19. Nuk ka lidhje midis testimit për HIV dhe grupmoshës të MSM-ve
20. Nuk ka lidhje midis përdorimit të prezervativit me lloje të ndryshme partnerësh dhe grupmoshës të MSM-ve

21. Nuk ka lidhje midis shmangies së shërbimeve shëndetësore dhe stigmës te MSM
22. Nuk ka lidhje midis shmangies së testimit për HIV dhe stigmës te MSM
23. Nuk ka lidhje midis dhunes fizike dhe stigmës ndaj MSM-ve

## **KAPITULLI III. METODOLOGJIA**

### **3.1 Tipi i studimit**

Studimi është i tipit kros-seksional, dhe në popullatën e MSM-ve dhe PDI-ve u krye në qytetet kryesore në Shqipëri (viti 2019), përkatësisht në tre qytete për popullatën MSM (Tiranë, Durrës, Elbasan), dhe në katër qytete për PDI (Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Berat). Gjithashtu, arsye tjetër që këto qytete u identifikuan për realizimin e studimit është prania e OJQ-ve që ofrojnë shërbime parandaluese për popullatën e MSM-ve dhe PDI-ve. Studimi në popullatën romë u krye në qytetin e Tiranës (viti 2011).

### **3.2 Kampionimi**

Për të rekrutuar pjesmarrësit në studim për Përdoruesit e drogave me injektim (PDI) dhe Meshkujt që kryejnë seks me Meshkuj (MSM) u përdor kampionimi i udhëhequr nga përgjigjedhësi (RDS). RDS është një variant i një metode të referimit të kampionimit të referimit zinxhir, e cila kur zbatohet dhe analizohet siç duhet, jep të dhëna përfaqësuese të popullatave në studim. Rekrutimi fillon me një numër anëtarësh të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme nga popullata në studim të referuar si "fara". Pas përfshirjes në studim dhe përfundimit të të gjitha etapave të studimit, çdo fare i jepet një sasi fikse (zakonisht jo më shumë se tre) kuponësh me numër unik me të cilët do të rekrutojë anëtarë të tjerë të popullatës në studim që plotësojnë kriteret. Këta persona të rekrutuar, të cilët gjithashtu përfshihen dhe plotësojnë etapat përkatëse të studimit, konsiderohen si vala e parë e pjesmarrësve. Secilit pjesmarrës në valën e parë që përfundon etapat e studimit i jepet më pas një numër fikse kuponësh (tre kupona) me të cilët do të rekrutojë pjesmarrës të tjerë. Valët e njëpasnjëshme të rekrutimit, që në mënyrë ideale rezultojnë në zinxhirë të gjatë rekrutimi të të anketuarve, vazhdojnë derisa të arrihet madhësia e kampionit (158,159).

Secilit pjesmarrës në studim pyetet për madhësinë e rrjetit të tij shoqëror, i cili lidhet drejtpërdrejt me kriteret e pjesmarrjes në studim dhe përcakton probabilitetin e përzgjedhjes së secilit pjesmarrës në studim. Madhësitë e rrjeteve sociale të vetë-raportuara konsiderohen si korniza e kampionimit që përdoret për të përlllogaritur peshimin për

nxjerrjen e vlerësimeve. Peshimi aplikohet në mënyrë të anasjelltë, ku atyre me madhësi më të mëdha të rrjetit shoqëror (aftësia për të rekrutuar më shumë pjesëmarrës dhe zakonisht të mbipërfaqësuar në një metodë standarde të kampionimit të topit të borës) u jepet relativisht më pak peshë dhe atyre me madhësi më të vogël të rrjetit shoqëror u sigurohet një peshë relativisht më e madhe. Për më tepër, të dhënat analizohen me modelimin matematikor të procesit të rekrutimit (lidhjet e rrjetit shoqëror të rekrutëve-rekrutuesve) për të gjeneruar probabilitetet relative të përfshirjes dhe për të matur nivelin e përpjekjes për rekrutim dhe homofili (rekrutimi jo i rastësishëm i personave me karakteristika të ngjashme me personin që rekruton). Procesi i rekrutimit, kush pjesmarrës ka rekrutuar kë, monitorohet nëpërmjet numrave unik në kuponin që zotëron secili prej pjesëmarrësve. Numrat unik të kuponit sigurojnë gjithashtu anonimitetin e pjesmarrësve në studim duke lidhur secilin të anketuar me pyetësin e tyre dhe rezultatet e testeve biologjike, duke shmangur kështu nevojën për të mbledhur emra, adresa ose informacione të tjera personale. Kur plotësohen të gjitha kërkesat metodologjike dhe teorike, RDS jep vlerësime të parametrave të popullatës mbi të cilat mund të bëhen konkluzione rreth karakteristikave dhe sjelljeve të popullatës së kampionuar (160,161).

Kampionimi për Popullatën Rome bë duke përdorur teknikat standarte të kampionimit në grupe të njëjsteve shtëpiake. Së pari, u rishikua dhe u verifikua hartëzimi i vendbanimeve Rome në Tiranë (162). Pas verifikimit të hartave, nga 11 vendbanime Rome të hartëzuara u përzgjedhën në mënyrë rastësore 3 prej tyre (secila prej tyre përfaqëson një grup). Së dyti, një metodë kampionimi rastësor u përdor për të përzgjedhur njësi shtëpiake të veçanta në tre grupet e përzgjedhura. Një mashkull dhe një femër, të moshës 18-49 vjeç, u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme në çdo njësi shtëpiake për të marrë pjesë në studim. Të gjithë personat e përzgjedhur u ftuan të realizonin komponentët e studimit.

### **3.3 Kriteret e pranimit dhe kriteret përjashtuese**

#### **Popullata MSM**

Kriteret e pranimit:

- Mashkull që kanë pasur marrëdhënie anale me një mashkull tjetër gjatë vitit të fundit
- Mosha  $\geq 18$  vjeç
- Zotëron një kupon të vlefshëm rekrutimi
- Ka jetuar në zonën e studimit për të paktën tre muaj përpara studimit
- I aftë dhe i gatshëm për të dhënë pëlqimin e informuar me shkrim ose verbal për të marrë pjesë në studim

Kriteret e përjashtimit:

- Pjesëmarrja e mëparshme në studimin në të njëjtën ose në qendër tjetër të studimit
- Pamundësia për të dhënë pëlqim të informuar
- Nuk dëshiron të plotësojë një pyetësor të sjelljes



- Nuk dëshiron të japë gjak për testet për infeksione

### **Popullata PDI**

Kriteret e pranimit:

- Person qe ka injektuar drogë për qëllime jo-mjeksore ne muajin e fundit
- Mosha  $\geq 18$  vjeç
- Zotëron një kupon të vlefshëm rekrutimi
- Ka jetuar në zonën e studimit për të paktën tre muaj përpara studimit
- I aftë dhe i gatshëm për të dhënë pëlqimin e informuar me shkrim ose verbal për të marrë pjesë në studim

Kriteret e përjashtimit:

- Pjesëmarrja e mëparshme në studim në të njëjtën ose në qendër tjetër të studimit
- Pamundësia për të dhënë pëlqim të informuar
- Nuk dëshiron të plotësojë një pyetësor të sjelljes
- Nuk dëshiron të japë gjak për testet për infeksione

### **Popullata Rome**

Kriteret e pranimit:

- Person mashkull ose femër që e identifikon veten si Rome
- Mosha 18-49 vjeç
- I/e aftë dhe i gatshëm për të dhënë pëlqimin e informuar me shkrim ose verbal për të marrë pjesë në studim

Kriteret e përjashtimit:

- Pjesëmarrja e mëparshme në studim në të njëjtën ose në qendër tjetër të studimit
- Pamundësia për të dhënë pëlqim të informuar
- Nuk dëshiron të plotësojë një pyetësor të sjelljes

## **3.4 Madhësia e kampionit**

Formula e mëposhtme u perdor për përlllogaritjen e madhësisë së kampionit për MSM dhe PDI

$$n = D \frac{\left[ \sqrt{2P(1-P)}Z_{1-\alpha} + \sqrt{P_1(1-P_1) + P_2(1-P_2)}Z_{1-\beta} \right]^2}{(P_2 - P_1)^2}$$

Ku:

D= efekti i skicimit

$P_1$  = perqindja e vleresuar në kohën e vëzhgimit të parë

$P_2 - P_1$  = madhesia e ndryshimit qe kerkohet te zbulohet

$$P = (P_1 + P_2) / 2;$$

$Z_{1-\alpha}$  = i korespondon mundësisë për tq arritur në përfundimin se ndryshimi i vëzhguar ( $P_2 - P_1$ ) nuk do të kishte ndodhur rastësisht; dhe

$Z_{1-\beta}$  = i korespondon shkallës së besueshmërisë së dëshirueshme për të qenë të sigurt për zbulimin e madhësisë së ndryshimit ( $P_2 - P_1$ ) nëse ajo ka ndodhur

$$\alpha = 0.05 \quad (Z_{1-\alpha} = 1.65) \quad \beta = 0.20 \quad (Z_{1-\beta} = 0.84)$$

Për popullatën rome efekti i skicimit të kampionit u vlerësua 2. Niveli i saktësisë u vendos në 0.05 për testin e njëanshëm me fuqi 80%. Duke marrë në konsideratë mundësinë e mospërgjigjes madhësitë e kampionit u rritën me 10-15%

Bazuar në llogaritjet sipas formulës së mësipërme madhesia e dëshirueshme e kampionit sipas qyteteve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 2. Madhesia e përllogaritur e kampionit për MSM, PDI dhe popullatën rome. (ne kllapa madhësia e arritur)**

	Tirana	Elbasan	Durres	Berat	Gjithsej arritur
MSM	300 (279)	150 (136)	150 (139)	-	554
PDI	300 (305)	150 (150)	150 (150)	150	755
Popullata Rome	415 (415)				

Duke marrë në konsideratë faktin që popullata e MSM dhe PDI është më e madhe në kryeqytet, dhe se shumë prej anëtarëve të këtyre komuniteteve, veçanërisht ata që janë më të hapur homoseksualë dhe më të rinj, vijnë të jetojnë në Tiranë për shkak të një mjedisi më pranues ndaj MSM-ve, madhësia e kampionit të studimit në Tiranë ishte më e madhe në krahasim me qytetet e tjera.

### 3.5 Procesi i rekrutimit

Fillimisht, për të dyja popullatat në studim, MSM dhe PDI katër fara u përzgjedhën për qytetin e Tiranës dhe dy për qytetet e tjera. Farat u zgjedhën me rrjete të mëdha shoqërore dhe bazuar në karakteristika të ndryshme; nga zona të ndryshme gjeografike të qyteteve, të martuar dhe të pamartuar, me vetë-identitete të ndryshme dhe me nivele të ndryshme socio-ekonomike (163). Megjithatë, bazuar në ecurinë e rekrutimit dhe faktin që disa fara nuk mundësuan rekrutimin e personave të tjerë, apo që zinxhirët e rekrutimit ndaluan së prodhuari, u shtuan më shumë fara në të gjitha qytetet. Farat u identifikuan përmes stafit të

organizatave që punojnë më komunitetin e MSM-ve dhe që ofrojnë shërbime parandaluese në këto qytete. Farave të identifikuara për popullatën e studimit iu dhanë secilit nga tre kuponë të koduar në mënyrë unike, të cilët u përdorën për rekrutimin e pjesëmarrësve të tjerë në studim. Kuponët numëroheshin në atë mënyrë që rekrutuesi origjinal (d.m.th. fara) të mund të njihej dhe që zinxhirët dhe numri i valëve të mund të gjurmoheshin (163). Fluksi i pjesëmarrësve, rritja e zinxhirit dhe marrja e kuponit u monitoruan në mënyrë elektronike, nga një bazë të dhënash e menaxhimit të kuponëve në Excel.

Personat që paraqitën një kupon të vlefshëm rekrutimi në qendrën e studimit u kontrolluan nëse plotësonin kriteret e pjesëmarrjes në studim, dhanë pëlqimin e informuar për një intervistë ballë për ballë, këshillim dhe testim për HIV, Sifiliz dhe Hepatit C. Çdo intervistë zgjati afërsisht 50 minuta. Pas intervistës, çdo të anketuari iu dha një numër i caktuar kuponësh (jo më shumë se tre kuponë) për t'i përdorur në rekrutimin e personave të tjerë. Nuk u mblodh asnjë informacion personal identifikues. Për të siguruar konfidencialitetin, pyetësorët e të anketuarve dhe testet biologjike u identifikuan duke përdorur një numër unik identifikimi të studimit të dhënë në kuponët e rekrutimit.

Për Popullatën Rome, u realizua kontakti i parë në shtëpi duke i ftuar personat e zgjedhur të vinin në vendin e studimit. Intervistues të trainuar plotësuan pyetësorin pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga të intervistuarit (pjesëmarrësit u jepej mundësia për dhënien e pëlqimit me gojë në praninë e një dëshmitari nëse nuk dëshironin ta bënin me shkrim). Intervistuesit e kryenin plotësimin e pyetësorit vetëm për vetëm me të intervistuarin në një mjedis të veçantë.

### **3.6 Pasqyra e rekrutimit**


Për popullatën MSM Tirana kishte madhësinë më të madhe të kampionit të arritur me 279 pjesëmarrës në studim. Numri maksimal i valëve ishte në Elbasan (8 valë). Të kesh gjashtë ose më shumë valë rekrutimi konsiderohet adekuate për studimet RDS. Procesi i rekrutimit ishte i ngadaltë në të tre qytetet, duke rezultuar në shtimin e farave, dy në Tiranë dhe një për dy qytetet të tjera. Megjithatë, madhësia e planifikuar e kampionit pothuajse u arrit. Kjo mund të pasqyrojë nivelin e lartë stigmës ndaj komunitetit të MSM, gjë e cila sjell si pasojë fshehjen dhe moslidhjen e mirë në rrjete të kësaj popullate. Megjithatë, madhësia e kampionit të arritur për të gjitha qytetet u konsiderua si adekuate për analizën e studimit.

Për popullatën e PDI, Tirana kishte madhësinë më të madhe të kampionit të arritur me 305 pjesëmarrës në studim. Numri maksimal i valëve ishte në Tiranë (10 valë). Procesi i rekrutimit shkoi mirë në të gjitha vendet dhe nuk kishte nevojë për të shtuar më shumë fara për të arritur madhësinë e mostrës.


Grafikët e rekrutimit u krijuan për çdo qendër të krytjes së studimit për të zbuluar çdo gabim në numërimin e kuponit dhe për të vlerësuar numrin dhe përbërjen e zinxhirëve. Farërat janë në krye të çdo zinxhiri.




**Figura 1. Zinxhiri i rekrutimit të MSM-ve, Tiranë**




**Figura 2. Zinxhiri i rekrutimit të MSM-ve, Durrës**




**Figura 3. Zinxhiri i rekrutimit të MSM-ve, Elbasan**




**Figura 4. Zinxhiri i rekrutimit të PDI-ve, Tiranë**



**Figura 5. Zinxhiri i rekrutimit të PDI-ve, Durrës**



**Figura 6. Zinxhiri i rekrutimit të PDI-ve, Elbasan**



**Figura 7. Zinxhiri i rekrutimit të PDI-ve, Berat**

### **3.6 Mbledhja e të dhënave**

Për realizimin e studimit është përdorur një pyetësor i standardizuar i sjelljes i bazuar në udhëzuesin e OBSH për studimet biologjike dhe të sjelljes te popullatat kyç. Pyetësorët përfshijnë pyetje mbi: karakteristikat social-demografike, historinë seksuale dhe llojet e partnerëve, sjelljet e lidhura me injektimin e drogës, përdorimin e prezervativit, njohuritë për IST, simptomat e IST, njohuritë, qëndrimet dhe sjelljet mbi HIV/AIDS, testimin për HIV, stigmën dhe diskriminimin të lidhur me HIV/AIDS, gjendjen shëndetësore dhe sjelljet e lidhura me shëndetin.

Vendndodhjet e kryerjes së studimit u përzgjedhën në mënyrë që të ishin të aksesueshme lehtësisht për pjesëmarrësit në studim dhe të sigurta. Para fillimit të intervistës u kontrollua kuponi i paraqitur nga pjesëmarrësi potencial për datën, origjinalitetin, për të konfirmuar nëse pjesëmarrësi i mundshëm nuk ishte regjistruar më parë. Përshtatshmëria e pjesëmarrësit të mundshëm u vlerësua përmes një interviste të shkurtër personale për të kontrolluar përshtatshmërinë duke plotësuar kriteret e pranueshmërisë të listuara më sipër. Pyetësorët u administruan pasi kishin marrë pëlqimin me shkrim të pjesëmarrësve. Çdo intervistë zgjati afërsisht 50 minuta.

### **3.7 Procedurat laboratorike**

Pas përfundimit të pyetësorit të sjelljes, pjesëmarrësit iu nënshtruan pjesës biologjike të studimit, e cila përbëhej nga sa vijon: këshillim para testit, teste të shpejta duke përdorur gjak të plotë të marrë me gisht, këshillim pas testit dhe referim për rezultate pozitive të IST. Rezultatet e testit u lidhën duke përdorur kodet unike të identifikimit të pjesëmarrësve. Në rast të një rezultati reaktiv, një mostër gjaku venoz u mor nga pjesëmarrësi për teste të mëtejshme konfirmuese. Testimi konfirmues u krye në Laboratorin Kombëtar të Referencës, në Institutin e Shëndetit Publik, duke përdorur analizën imunosorbente të lidhur me enzimën (ELISA) dhe Western Blot HIV1/2. Të gjithë pjesëmarrësit që kishin një test pozitiv të konfirmuar për HIV u referuan për ndjekje dhe kujdes të vazhdueshëm në QSUT.

### **3.8 Analiza statistikore e të të dhënave**

Një bazë të dhënash e hartuar paraprakisht në softuerin SPSS version 24, mundesoi hedhjen e të dhënave të mbledhura nga të gjitha qendrat e kryerjes së studimit. U përdorën frekuenca dhe tabela të kryqëzuara për të kontrolluar vlefshmërinë dhe logjikën e të gjitha variablave në grupet e të dhënave. Për PDI dhe MSM, të dhënat u transferuan nga programi SPSS në një program të veçantë për analizën e të dhënave të RDS (RDS Analyst) (164). Bazuar në të dhënat për rrjetin të mbledhura nga pjesëmarrësit në studimit, RDS Analyst bën të mundur vlerësimin e karakteristikave të një rrjeti më të gjerë të PDI dhe MSM.



Analiza përdori vlerësuesin e kampionimit të njëpasnjëshëm Giles. Vlerësuesi i kampionimit të njëpasnjëshëm përdor informacion në lidhje me madhësinë e popullatës së fshehur për të prodhuar vlerësime (165).

Parametra të tjerë të përdorur në analizën e univariate përfshijnë identifikimin e numrit unik të pjesëmarrësit në studim, numrin e kuponit të pjesëmarrësit dhe numrat e kuponit të rekrutimit që i jepen secilit pjesëmarrës dhe numrin maksimal të kuponëve. Të dhënat e madhësisë së rrjetit iu kërkuan të gjithë pjesëmarrësve për të përcaktuar numrin e personave që çdo pjesëmarrës njih dhe që plotëson kriteret e pranueshmërisë në studim. Ata me madhësi të rrjeteve më të mëdha marrin më pak peshë pasi probabiliteti i tyre për t'u përfshirë në studim është më i madh dhe ata me madhësi më të vogël të rrjetit marrin më shumë peshë pasi probabiliteti i tyre për t'u përfshirë është më i vogël.

Për analizën e agreguar, peshat e rrjetit u llogaritën nga RDS Analyst për çdo qytet të veçantë (çdo kampion u pa si një komponent i pavarur i rrjetit) dhe më pas u shtuan në bazën e të dhënave të përbërë nga të gjitha qytetet e kampionuara. Më pas u përlllogarit një peshë e popullsisë që merr në konsideratë ndryshimet në madhësinë e popullsisë për çdo qytet. Peshat e rrjetit dhe peshat e popullsisë u shumëzuan për të krijuar një peshë totale. Këto të dhëna u analizuan në SPSS me gabime standarde të llogaritura duke përdorur bootstrapping.

Disa teste statistikore u përdorën për të analizuar, përshkruar dhe vlerësuar të dhënat e këtij studimi. Ato u përzgjedhën në varësi të natyrës së variabëlve. Numrat absolutë dhe përqindjet përkatëse u paraqitën për variablat kategorikë, ndërsa për variablat numerikë u përshkruan madhësitë e prirjes qendrore (vlera mesatare) dhe madhësitë e dispersionit (deviacioni standard).

Në paraqitjen e prevalencës të indikatorëve të ndryshëm u përlllogarit dhe intervali i besimit 95% përkatës, duke mundësuar një paraqitje më të qartë të prevalencës së vërtetë e fenomenit të matur në popullatë.

Për vlerësimin e lidhjeve statistikore midis variabëlve kategorike u përdor testi statistikor hi katror. Në rast se të dy variablet kategorikë kishin nga dy kategori secili, u përdor testi ekzakt i Fisherit (Fisher's exact test) i cili është superior dhe më e saktë se sa testi hi katror.

Në analizën e agreguar për të gjitha qytetet, për të përcaktuar faktorët e lidhur apo faktorët të cilët parashikojnë gjasat e pranisë së faktorëve të varur në studim u përdor Regresioni Logjistik Binar. Për të kontrolluar efektin e variabëlve të ndryshëm konfundues, u përdorën modelet të Regresionit Logjistik Binar të kontrolluar për variabla të caktuara. Për të testuar përshtatshmërinë e modeleve të regresionit logjistik, u përdor testi Hosmer-Lemeshow dhe domethënia statistikore e tij.

### 3.9 Konsiderata etike

Pjesëmarrja në studim ishte tërësisht në baza vullnetare. Çdo pjesëmarrës u informua për objektivat e studimit dhe u informua për opsionin për të mos iu përgjigjur asnjë pyetjeje të cilës nuk dëshironte t'i përgjigjej dhe për t'u tërhequr nga studimi në çdo kohë. Pas shpjegimit të kujdesshëm të studimit, secilit pjesëmarrës iu dha formulari i pëlqimit për të lexuar ose, nëse ishte e nevojshme, formulari i pëlqimit iu lexua të pjesëmarrësit nga një anëtar i stafit. Të gjithë pjesëmarrësit në studim ose nënshkruan ose deklaruan verbalisht se ata i kuptonin dhe ishin dakord me të gjitha pikat e përfshira në formularin e pëlqimit përpara se të regjistroheshin në studim. Megjithatë pjesëmarrësit dhanë pëlqimin e informuar, u ndërmorën disa procedura për të minimizuar rrezikun e zbulimit të të dhënave

- Emrat ose informacione të tjera identifikuese nuk janë shkruar në pyetësor
- Të gjitha materialet (pyetësor, formularë të tjerë) pas mbarimit të etapave të studimit u ruajtën në zarfa të mbyllyr.
- Stafi nuk kërkoi identifikim nga asnjë pjesëmarrës.

## KAPITULLI IV. REZULTATET

### 4.1 Përdoruesit e Drogave me Injektiv

#### 4.1.1. Karakteristikat socio-demografike të PDI

Më shumë se nëntë nga dhjetë pjesëmarrësit në studim ishin meshkuj, një trend i ruajtur pothuajse në të gjitha rrethet ku u krye studimi. Për shkak të numrit të vogël të femrave në kampionin e PDI-ve, gjetjet e studimit nuk janë ndarë sipas gjinisë. Moshë mesatare e PDI-ve pjesëmarrës ishte 32.8 vjeç. PDI ishin më të rinj në Elbasan dhe më të mëdhenj në Durrës. Në total, një në shtatë PDI ishin më të rinj se 24 vjeç, ndërkohë që në Berat dhe Elbasan një në pesë PDI i përkasin kësaj grupmoshe. Rreth 9% e PDI janë pa arsim (më e ulta në Elbasan 2%, dhe më e larta në Durrës, 12%) dhe pak më pak se 1/3 e tyre (29.2%) raportojnë të kenë mbaruar arsimin e mesëm (duke variuar nga 22.1 % në Berat në 35.9 Durrës) (Tabela 3)

**Tabela 3. Moshë, seksi dhe arsimimi i PDI**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Seksi</b>										

Mashkull	295	97 (95.3,98.7)	143	86.4 (77.2,96.1)	149	99.4 (98.7,100.0)	146	96.8 (94.3,99.4)	92.8	83.1,97.1
Femër	10	3 (1.3, 4.8)	7	13.6 (3.8,22.7)	1	0.5 (0.1,1.2)	4	3.1 (0.5,5.6)	7.2	2.8,16.8
<b>Mosha</b>										
Mesatarja	33.4		33.7		31.1		32.3		32.8	
Mesorja	33		33		30		32		32	
<b>Grupmosha</b>										
≤24 vjeç	39	12.9 (8.6,17.2)	20	16.9 (8.2,25.5)	28	19.7 (11.6,27.7)	31	19.9 (14.38,25.4)	14.3	6.5,22.4
>24 vjeç	266	87 (82.9,91.5)	130	83.1 (74.4,91.7)	122	80.3 (72.2,88.3)	119	80.1 (74.6,85.6)	85.7	72.8,96.2
<b>Arsimi</b>										
Pa shkollë	28	9.1 (5.6,12.7)	12	12.1 (0.6,22.9)	4	2 (0.2,3.8)	12	8.3 (4.3,12.6)	8.6	2.7,16.9
Niveli më i lartë i arsimit										
I ulët (9 vjet ose më pak)	207	66.8 (45.8,57.9)	104	55.6 (49.4,62.4)	104	67.9 (60.2,73.1)	117	77.2 (70.6,84.8)	65.9	56.8,71.2
I mesëm	81	28.7 (23.0,34.3)	38	35.9 (22.9,49.7)	40	29.1 (21.2,37.1)	32	22.1 (16.0, 28.2)	29.2	18.6,39.2
Universitet	17	4.5 (2.8,7.3)	8	8.5 (2.1,15)	6	3 (1.5-6.4)	1	0.7 (0.6, 2.1)	4.9	1.8,12.2

Më shumë se një e treta e popullatës të PDI (39%) ka qenë ndonjëherë i/e martuar (duke filluar nga 32% në Elbasan në 46% në Berat ) dhe më shumë se 90% janë martuar në moshën 18 vjeç e lart. Në kohën e studimit rreth dy të tretat e popullsisë PDI (68%) nuk ishin të martuar dhe nuk jetonin me një partner seksual, duke filluar nga 50% në Durrës deri në 73% në Elbasan. Rreth 17% e të gjithë PDI pjesëmarrës kanë shpenzuar një muaj ose më shumë larg shtëpisë në vitin e kaluar me variacione të konsiderueshme sipas qyteteve: 50% në Durrës, 39% në Elbasan dhe rreth 20% në Tiranë dhe Berat.

## 4.1.2. Përdorimi i alkoolit dhe drogës

### 4.1.2.1 Alkooli

PDI nuk kanë raportuar nivele të larta të përdorimit të alkoolit. Vlerësimet e popullatës, tregojnë se vetëm 7% e tyre konsumojnë alkool çdo ditë, ndërsa 34% konsumojnë alkool të paktën një herë në javë. Më shumë se gjysma e PDI-ve (62%) besohet se konsumojnë alkool më pak se një herë në javë ose kurrë (Tabela 4)

**Tabela 4. Përdorimi i alkoolit**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Shpeshësia e përdorimit të alkoolit (N=209)</b>										
Asnjëherë	226	75.0 (70.5,79.5)	84	55.2 (43.1,67.2)	77	53.8 (46.4,61.3)	125	83.8 (78.2,89.5)	52.6	39.0,65.8
Një herë në muaj	29	10.0 (6.4,13.3)	6	4.1 (0.3,8.1)	1	0.6 (0.2,1.5)	10	6.7 (3.2,10.2)	13.8	6.4,27.1

2-3 herë në javë	16	4.0 (2.1,6.0)	18	12 (5.4,18.9)	46	28.8 (21.3,36.2)	4	2.3 (0.3,4.4)	11.4	5.6,21.8
2-4 herë në javë	21	6.7 (4.0, 9.3)	28	22.3 (10.5,33.7)	16	10.2 (5,15.5)	7	4.96 (1.7,8.1)	15.9	7.1,31.8
4 ose më shumë herë në javë	13	4.4 (2.0,7.0)	14	6.1 (2.8,9.4)	10	6.3 (2.1,10.5)	4	2.0 (0.1,4.0)	6.1	2.4,14.7

## 4.1.2.2 Droga

### 4.1.2.2.1 Mosha në përdorimin dhe injektimin e parë të drogës

Rreth 42% e PDI-ve kanë përdorur për herë të parë drogë në moshën 18 vjeç ose më herët (duke filluar nga 39% në Berat në 71% në Durrës) ndërsa 7% kanë injektuar drogë për herë të parë në këtë moshë (nga 10% në Tiranë në 14% në Durrës). Përdorimi i hershëm i drogës (në moshën më pak se 14 vjeç) ishte më i lartë në Durrës (30%) dhe më i ulët në Tiranë (9%) dhe akoma më i ulët në rrethet e tjera (Tabela 5).

**Tabela 5. Mosha në përdorimin dhe injektimin e parë të drogës**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Mosha në përdorimin e parë të drogës</b>										
≤14 vjeç	30	9.0 (6.1,12.0)	41	29.8 (18,41.6)	6	5.4 (1.6,9.3)	7	4.4 (1.8,7.3)	8.1	3.4,18.3
15-18 vjeç	106	35.2 (29.5,40.9)	57	40.9 (30.0,52.1)	53	34.7 (26.7,42.6)	51	34.2 (27.3,41.0)	33.9	22.9,47.3
19-24 vjeç	118	40.5 (34.4,46.5)	36	20.5 (12.3,28.5)	67	45.5 (37.8,53.1)	54	36.9 (30.5,43.3)	30.5	17.0,41.0
≥ 25 vjeç	51	15.2 (10.7,19.8)	16	8.6 (3.3, 13.9)	24	14.3 (8.2,20.4)	38	24.3 (18.1,30.6)	27.4	17.0,41.0
<b>Mosha në injektimin e parë të drogës</b>										
≤14 vjeç	3	0.7 (0.1,1.4)	1	0.4 (0.3, 1.2)	0		1	0.6 (0.3, 1.7)	1.8	0.2,11.6
15-18 vjeç	27	9.6 (5.5,13.7)	22	13.3 (7.1,19.6)	5	3.6 (0.5,6.8)	3	2.1 (0.2,4.0)	5.5	1.6,16.8
19-24 vjeç	143	47.5 (41.7,53.4)	53	42.7 (31.7,53.6)	74	52.3 (43.3,61.1)	61	39.5 (33.1,46.0)	32.4	21.5,45.7
≥ 25 vjeç	132	42.2 (36.6,47.7)	74	43.4 (33.1,53.7)	71	44 (34.8,53.3)	85	57.6 (51.1,64.1)	60.3	46.7,72.4

### 4.1.2.2.2 Kohëzgjatja e përdorimit dhe injektimit të drogës

Rezultatet e agreguara për të gjitha qendrat e studimit tregojnë se 85% e PDI-ve kanë përdorur ndonjë drogë të paligjshme për më shumë se 5 vjet (duke filluar nga 74% në Elbasan deri në 93% në Durrës). Tre të katërtat e pjesëmarrësve në studim kanë injektuar drogë për më shumë se 5 vjet dhe një numër i vogël i PDI-ve (2.6%) kanë injektuar për 12 muaj ose më pak. Përqindja e PDI-ve që kanë injektuar drogë për më shumë se 5 vjet është më e lartë në Tiranë (61%) dhe më e ulët në Berat (31%) (Tabela 6).


**Tabela 6. Kohëzgjatja e përdorimit dhe injektimit të drogës**

	Tiranë N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Kohëzgjatja e përdorimit të drogës</b>										
≤ 1 vit	0		0		2	1.1 (0,2,3.0)	0		0.1	NP*
2-5 vjet	43	13.4 (9.6,17.2)	8	7.1 (1.46,12.9)	35	24.7 (16.4,32.9)	35	23.7 (17.5,30.0)	14.6	8.0, 23.2
> 5 vjet	262	86.7 (82.8,90.4)	142	92.8 (87,98.5)	113	74 (65.6,82.6)	115	76.3 (70.0,82.5)	85.4	76.3,92.4
<b>Kohëzgjatja e injektimit të drogës</b>										
≤ 1 vit	19	6.2 (3.4,9.0)	6	4.7 (0.5,8.7)	24	18.7 (11.6,25.7)	18	12.3 (7.8,16.7)	2.6	0.6,9.8
2-5 vjet	99	33.3 (27.9,38.6)	54	46.6 (34.9,58)	58	40.3 (32.5,48.1)	85	57.1 (50.0,64.0)	21.8	12.9,34.5
> 5 vjet	187	60.5 (55.2,65.9)	90	48.6 (37.3,60.3)	62	40.9 (32.4,49.4)	46	30.7 (24.0,37.3)	75.1	62.7,84.9


\*Nuk përlloraritet

#### 4.1.2.3 Shpeshtësia e injektimit të drogës në muajin e fundit

Për sa i përket shpeshtësisë së injektimit të drogës në muajin e fundit, më shumë se 4 në 5 PDI (81%) kanë injektuar 2 ose më shumë herë në ditë gjatë muajit të kaluar (Grafiku 1). Vërehen variacione të mëdha sipas qyteteve në studimi, që shkojnë nga 37% në Berat, në 83% në Elbasan, dhe 85% në Tiranë (Grafiku 2).




**Grafiku 1. Shpeshtësia e injektimit të drogës**



**Grafiku 2. Shpeshësia e injektimit të drogës sipas qyteteve**

#### 4.1.2.4 Llojet e drogës të përdorur dhe injektuar në muajin e fundit

Në përgjithësi, droga më e përdorur gjatë muajit të fundit ishte heroina (99%) e ndjekur nga kokaina (50%) dhe marihuana/kanabisi (43%) ndërsa amfetaminat u përdorën nga vetëm 1% e popullatës të PDI-ve. Pothuajse të gjithë PDI (99%) kanë injektuar heroinë gjatë muajit të kaluar, rreth një e treta (34%) kanë injektuar kokainë dhe 16% kanë injektuar heroinë dhe kokainë (Grafiku 3).



**Grafiku 3. Prevalenca e drogave të përdorura dhe të injektuara gjatë muajit të fundit**

Për sa i përket vendndodhjes së studimit, heroina është përdorur nga pothuajse e gjithë popullata e PDI-ve në Tiranë, Durrës dhe Elbasan dhe nga më shumë se nëntë të dhjetat e popullatës të PDI-ve në Berat. Përdorimi i kokainës muajin e kaluar ishte veçanërisht i lartë në Elbasan (69%) dhe Durrës (62%), prevalenca e përdorimit të marihuanës ishte më e lartë në Elbasan (79%) ndërsa prevalenca e përdorimit të heroinës dhe diazepamit ishte më e lartë në Berat (43%). Prevalenca e injektimit të heroinës ndjek nga afër prevalencën e përdorimit të heroinës në rajon. Është interesante se prevalenca e injektimit të kokainës dhe kokainës së bashku me heroinën ishte më e larta në Tiranë (përkatësisht 39% dhe 17%) dhe Durrës (përkatësisht 30% dhe 13%), ndërsa injektimi i heroinës së bashku me diazepam u raportua nga 43% PDI-ve në Berat dhe 27.4% e PDI-ve në Durrës (Tabela 7).


**Tabela 7. Droga të përdorura dhe të injektuara në muajin e fundit**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Drogat e përdorura në muajin e fundit</b>										
Heroinë	305	100	145	96.7 (93.3,99.0)	145	97.1 (95.3,98.9)	137	91.9 (88.4,95.4)	99.2	98.2,99.9
Kokainë	150	46.5 (40.3,52.3)	99	61.8 (50.2,73.3)	107	68.5 (6.3,76.5)	35	23.5 (17.5,29.3)	49.8	37.2,60.6
Heroinë +kokain	53	16.4 (12.5, 20.2)	34	19.5 (11.8,27.9)	21	14.8 (8.5, 20.9)	3	1.9 (0.2, 3.6)	16	9.6,28.3
Heroinë +valium	26	8.1 (5.1,11.2)	47	27.6 (18.1,36.8)	26	16.9 (10.5,23.3)	62	43 (35.0,50.0)	12.4	3.7, 24.4
Krak	4	0.8 (0.2,1.3)	9	3.5 (1.4,5.8)	38	23.3 (15.7,30.8)	7	4.3 (106,7.1)	3.8	0.1,8.2
Amfetam ina	1	0.3 (0.12, 0.8)	1	1.4 (1.3,4.3)	8	5.5 (1.8,9.3)	1	0.5 (0.3, 1.4)	1.1	0.1,4.3
Valium +prometa zinë	4	1.8 (0.3,2.0)	6	2.6 (0.3, 5.1)	2	1.8 (0.7,4.3)	0		1.4	0.1,9.6
Ekstazi	7	2.1 (0.3,4.0)	2	0.8 (0.3,2.0)	6	3.5 (0.9,6.2)	1	0.5 (0.3, 1.4)	2.1	0.3,12.5
Marihua na/kanab is	118	35.7 (29.9,41.4)	72	51.3 (39,63.6)	120	79.1 (73.1,85.1)	94	63.4 (56.4,70.3)	43.3	33.5,55.4
<b>Drogat e injektuara në muajin e fundit</b>										
Heroina	305	100	141	95.6 (92.1,99.1)	147	98 (96.2,99.9)	137	91.8 (88.5,95.2)	99.0	98,99.8
Kokaina	127	39.3 (33.3,45.1)	62	29.9 (21,39.1)	10	8.1 (2.7,13.4)	12	8.1 (4.3, 11.8)	33.6	24.6,44.5
Heroinë + kokainë	55	17.3 (13.1, 21.1)	28	12.9 (8.2,17.5)	0		1	0,6 (0.2,1.5)	14.2	5.2, 22.3
Heroinë +valium	20	6.2 (3.3,9.1)	46	27.4 (18.4,36.4)	1	1.2 (1,3.6.0)	61	42.1 (35.0,49.2)	9.2	3.5,19.2

#### 4.1.2.5 Sjelljet e shkëmbimit të ageve dhe pajisjeve të injektimit

##### 4.1.2.5.1 Injektimi me age/shiringë sterile në injektimin e fundit të drogës

Në përgjithësi, rreth tre të katërtat (75%) e popullatës të PDI-ve përdorën age/shiringë sterile herën e fundit që kanë injektuar drogë; kjo shifër ishte më e larta te PDI në Elbasan (88%) dhe më e ulëta në Tiranë (72%) (Grafiku 4).



**Grafiku 4. Përdorimi i ages/shiringës sterile në injektimin e fundit të drogës**

##### 4.1.2.5.2 Frekuenca e injektimit me age të përdorura në muajin e kaluar

Gjatë muajit të fundit rreth 42% e popullatës së PDI-ve ka injektuar drogë të paktën 1 herë me age të përdorura; 17% e popullatës të PDI kanë injektuar me age të përdorura të paktën gjysmën e kohës gjatë muajit të kaluar.

Prevalenca e injektimit me age të përdorura të paktën një herë në muajin e kaluar ishte më e lartë në Tiranë (48%). Gjithashtu përqindje më të larta të PDI në Tiranë (19%) raportojnë të kenë patur sjellje të tilla të rrezikshme shumë shpesh (gjithmonë ose shumicën e kohës) gjatë muajit të kaluar krahasuar me qytetet e tjera në studim (Tabela 8).

**Tabela 8. Shpeshësia e injektimit me age të përdorura gjatë muajit të kaluar**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Frekuenca e injektimit me gjilpëra të përdorura gjatë 1 muajit të fundit</b>										
Rreth gjysmë e kohës	2	0.3 (0.1,0.6)	8	4.4 (0.9,7.9)	1	0,6 (0,5,1,8)	3	2.2 (0.1,4.7)	0.8	0.1, 3.0



Kurrë	158	51.9 (45.9,57.6)	127	79.3 (68.8,90.0)	113	78.4 (71.9,84.9)	107	71.71 (64.5,78.9)	58.4	46.1,70.5
Ndonje here	86	29 (23.6,34.8)	13	12.6 (2.8,21.4)	19	12.1 (6.9,17.3)	20	13.0 (8.3,17.6)	24.9	15.3,38.3
Shumicën e herëve	31	9.9 (6.4,13.3)	2	3.6 (1.5,8.6)	17	8.7 (5,12.3)	11	7.25 (3.3, 11.0)	9.0	3.1,16.5
Gjithmonë	28	8.9 (5.7,12.1)	0		0		9	5.7 (2.4,9.1)	6.8	1.5,15.3

#### 4.1.2.5.3 Shkëmbimi i ageve/shiringave në muajin e fundit

Prevalenca më e lartë e sjelljeve të rrezikshme të lidhura me injektimin në Tiranë mbështetet edhe nga konstatimi se 48% e popullatës së PDI-ve në Tiranë shkëmbyen age/shiringa në muajin e kaluar, shifra më e lartë krahasuar me vendet e tjera të studimit (Tabela 9).

Nga ana tjetër, 88% e atyre që shkëmbyen age/shiringa e bënë këtë me një shok, 18% me një shpërndarës droge, 6% shkëmbyen me dikë në vendin e injektimit dhe partneren e rregullt seksuale.

Fenomeni i shkëmbimit të ageve/shiringave me një shok në muajin e fundit ishte më i përhapur në Elbasan (98%) dhe pak i pranishëm në Durrës (64%); shkëmbimi me një shpërndarës droge ishte shumë i rrallë në Durrës (2%) dhe Elbasan (2%), por shumë më i zakonshëm në Tiranë (20%) dhe Berat (17%).


Më shumë se një e katërta e PDI-ve në Berat që kanë shkëmbyer age/shiringa në muajin e fundit e bënë këtë me dikë në vendin e injektimit (26%), 15% e ndanë me një injektues profesionist; në Durrës 28% shkëmbyen age/shiringa me partneren/in e tyre të rregullt seksual (Tabela 9).

**Tabela 9. Shkëmbimi i ageve/shiringave në muajin e fundit**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Shkëmbyer age/shiringa në muajin e fundit</b>										
	147	48.2 (43.0,53.8)	23	15.3 (9.3,21.3)	38	22.2 (15.7,28.5)	43	28.2 (21.4,34.1)	41.6	30.0,54.3
<b>Llojet e njerëzve me të cilët i intervistuari ka shkëmbyer age/shiringa në muajin e fundit (nga ata që kanë shkëmbyer)</b>										
Partneri i rregullt seksual	9	4.9 (0.1,9.7)	3	28.4 (9,50.8)	0		0		6.3	2.5,15.0
Partner seksual që nuk e njihnit	1	0.6 (0.1,1.5)	0		0		1	1.9 (2.0, 5.8)	1.7	0.2,10.6
Shok	129	89.0 (83.8,94.2)	16	63.9 (37.1,89.8)	37	98.4 (95.5,99.8)	37	86.9 (79.1,94.7)	88.2	71.4,93.2
Shpërndarës droge	28	19.6 (11.7,27.7)	1	2.2 (10,14.3)	1	1.5 (3.3,6.2)	8	17.3 (5.4,28.7)	17.5	9.5, 27.0


Injektues profesionist	6	4.1 (0.1,10.0)	1	0.9 (1.6, 2.9)	0		7	15.4 (3.6,27.1)	4	0.1,12.5
Dikë në vendin e injektimit	8	5.4 (0.1,11.5)	3	10.7 (11.3,32.0)	4	8.3 (4.5,20.8)	11	25.7 (12.6,38.9)	6.3	1.8,16.6
<b>Numri i persoanve me të cilët i intervistuari ka shkëmbyer age/shiringa në muajin e fundit</b>										
1 person	91	65.3 (55.9,74.5)	11	44.8 (33.7,56.1)	7	23.6 (5.7,42.4)	12	25.2 (12.7,36.7)	60.8	50.5, 73.4
2-3 persona	49	30.7 (21.3,39.8)	10	47.5 (47.9,47.9)	26	67.1 (44.4,89.6)	15	36.7 (22.4,51.7)	33.9	22,1,44.6
≥4 persona	7	4.0 (1.3,6.6)	2	7.5 (4.1,33.7)	5	9.2 (0.8,16.7)	16	38.0 (26.6,49.6)	5.3	2.0,12.5

Në përgjithësi, 61% e PDI-ve që shkëmbyen age/shiringa e bënë këtë me 1 person në muajin e fundit dhe 34% shkëmbyen me 2-3 persona (Grafiku 5).



**Grafiku 5. Numri i personave me të cilët kanë shkëmbyer age/shiringa në muajin e kaluar**

Sipas qyteteve shkëmbimi me një person haset shumë më shpesh në Tiranë (65%), ndërsa shkëmbimi me 2-3 persona ishte më i zakonshme në Elbasan (67%). Në Berat më shumë se një e treta e PDI që shkëmbyen age/shiringa e bënë këtë me të paktën 4 persona të tjerë (Grafiku 6).



**Grafiku 6. Numri i personave me të cilët janë shkëmbyer age/shiringa në muajin e kaluar sipas qyteteve**

#### **4.1.2.5.4 Shpeshësia dhe mënyra e pastrimit të ageve/shiringave dhe injektimi me age të pastra gjatë muajit të fundit**

Tre të katërtat e PDI-ve që kanë shkëmbyer age/shiringa i kanë pastruar çdo herë ose shumicën e kohës që kanë injektuar gjatë muajit të fundit, por një e katërta raportojnë ta kenë bërë këtë vetëm ndonjëherë. Pastrimi i ageve të përdorura çdo herë në muajin e fundit ishte veçanërisht i ulët në Elbasan (7%) dhe më i lartë në Tiranë (61%) ndërsa pastrimi vetëm ndonjëherë ishte më i lartë në Berat (30%) dhe Tiranë (26%) (Tabela 10).


Metoda më e zakonshme për pastrimin e ageve ishte me ujë të ftohtë që raportohet nga 75% e PD-ve që kanë shkëmbyer pajisjet e injektimit, e ndjekur nga uji i nxehtë (21%). Përdorimi i ujit të ftohtë si agjent pastrimi ishte veçanërisht i lartë në Durrës (84%), uji i nxehtë ishte metoda e dytë më e përdorur e pastrimit të PDI në Tiranë (22%) dhe Elbasani kishte përqindjen më të lartë të PDI (31%) që përdorin zierjen si një metodë për pastrimin e ageve (Tabela 10).

**Tabela 10. Shpeshësia dhe mënyra e pastrimit të ageve dhe injektimit me age të pastra në muajin e fundit**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Shpeshësia e pastrimit të ageve të përdorura në muajin e fundit</b>										
Kurrë	0		0		1	1.9 (0,1,3.8)	0		0.1	-
Ndonjëhere	36	25.8 (18.3,33.6)	2	22.1 (0.3,44.6)	3	10.6 (3.9,25.4)	13	30.2 (17.6,42.7)	24.9	16.8,36.3
Shumicen e kohes	19	13.0 (7.5,18.5)	6	22.7 (7.6,37.2)	31	80.7 (66.8,94.4)	18	42.4 (30.6,54.2)	18.2	10.4-21.2
Gjithmonë	92	61.2 (53.1,69.0)	15	55.3 (33.4,76.5)	2	6.6 (0.4,14)	12	27.4 (15.4,39.1)	56.7	44.2,67.4
<b>Metoda e pastrimit të ageve (n=306)</b>										
Alkooli	1	1.1 (1.0,1.3)	3	7.4 (12.4, 27.3)	0		5	10.3 (2.2,18.0)	1.7	0.1,7.7
Duke zier	3	2.0 (0.1,4.8)	2	5.2 (5.2,5.2)	21	31.1 (20.3,42.3)	0		1.4	0.1,8.3
Ujë të ftohtë	110	74.8 (67.3,82.3)	37	83.9 (58.8,98.2)	52	68.9 (57.6,79.6)	30	71.7 (59.6,84.2)	75.1	62.0,87.1
Ujë i nxehtë	32	21.7 (15.0,29.3)	2	2.5 (14.7,19.5)	0		8	18.0 (7.4,28.2)	21.4	12.1,33.4
Zbardhues	1	0.4 (0.1,1.5)	0		0		0		0.3	-
<b>Shpeshësia e injektimit me age të pastra gjatë muajit të fundit</b>										
Kurrë	2	0.3 (0.1,0.7)	0		0		0		0.3	NP*
Ndonjëhere	60	17.9 (13.6, 22.2)	11	15.2 (4,26.3)	18	9.3 (5.3, 13.2)	23	15.3 (9.8, 20.7)	16.6	9.7,26.2
Pothuajse çdo herë	85	29.9 (24.6,35.3)	12	5.2 (2.3,8.1)	20	12.6 (7.4, 17.7)	20	13.0 (8.5,17.4)	24.8	14.9,36.5
Gjithmon	158	51.7 (45.9,57.7)	127	79.5 (68.2,90.8)	112	78 (71.0,85.0)	107	71.7 (64.6,78.7)	58.4	46.8,70.3

\*Nuk përllogaritet

Gjatë muajit të fundit rreth 58% e PDI-ve kanë injektuar drogë me age të pastra çdo herë që janë injektuar (duke filluar nga 52% në Tiranë në 80% në Durrës). Injektimi vetëm disa herë me age të pastra u praktikua nga 17% e PDI-ve, shifër kjo më e lartë në Tiranë (18%) dhe më e ulta në Elbasan (9%). PDI më të arsimuar dhe më te mëdhenj në moshë raportojnë ti kenë pastruar më shpesh aget/shiringat në muajin e fundit (Grafiku 7).



**Grafiku 7. Pastrimi i ageve/shiringave në muajin e fundit sipas grupmoshës dhe nivelit arsimor**

#### 4.1.2.5.5 Dhënia, huazimi, shitja ose marrja me qera e ageve dhe shiringave të përdorura

Në përgjithësi, rreth 37% e popullatës të PDI ka dhënë, shitur ose marrë me qera age dhe shiringa të përdorura, çdo herë ose pothuajse çdo herë që kanë injektuar, tregues ky më i lartë në Durrës (57%). Gjatë muajit të fundit, rreth 91% e PDI e kanë bërë këtë me një shok, 17% me një shpërndarës droge, dhe rreth 8% me partnerin e rregullt seksual (Tabela 11). Huazimi, shitja ose dhënia me qera e ageve të përdorura te një shok ishte më e përhapur në Tiranë (93%) dhe Berat (89%).


**Tabela 11. Shpeshësia e huazimit, shitjes, marrjes me qera të ageve të përdorura në muajin e fundit**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Shpeshësia e huazimit, shitjes, marrjes me qira të ageve të përdorura në muajin e fundit</b>										
Kurrë	4	2.8 (0.5,5.3)	1	3.1 (3,0)	3	7.5 (0.7,14.2)	4	9.1 (2.3, 15.9)	3.3	0.1, 9.5
Ndonjëhere	86	61.3 (53.7,69.6)	13	40.2 (11.5,66.1)	19	53 (41.9,65.7)	24	54.1 (38.7,69.0)	59.6	45.7,72.3
Pothuajse çdo herë	27	16.0 (10.0,21.7)	9	56.5 (30.4,85.3)	17	39.3 (27.1,50.20)	8	20.52 (7.0,34.2)	19.7	11.4,29.3
Gjithmonë	30	19.7 (14.1,25.2)	0		0		7	16.1 (7.6,24.8)	17.4	10.3,28.4

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej N=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
Nuk e di	0		0		0		0		0	
<b>Llojet e personave me të cilët i intervistuari ka dhënë hua, shitur, marrë me qera age të përdorura në muajin e fundit (jo kufizuar në një përgjigje)</b>										
Partneri juaj i zakonshëm seksual	12	7.1 (0.7,13.5)	4	21.2 (4.8,38.5)	0		0		7.6	2.5,15.0
Një partner seksual që nuk e njihnit	2	1.0 (0.1,2.5)	0		0		5	13.2 (0.0,26.4)	1.2	0.1, 7.6
Nje shok	140	93.1 (88.9,97.5)	26	58.6 (36,80.2)	0		35	88.9 (78.9,98.8)	91.2	83.9,98.4
Një tregtar	28	18.6 (11.5,25.9)	4	8.7 (7.0,24.2)	2	4.2 (5.8,14.1)	7	18.5 (6.2,31.0)	17.1	11.6,30.6
Dikush që nuk e njihje	6	3.2 (1.3,7.2)	1	2.2 (9.3, 13.9)	0		6	16 (2.8,29.2)	3.3	0.4,1.9
Dikush në rrugë	3	2.0 (0.1,4.5)	0		0		4	10.9 (0.7,22.9)	1.5	0.1,6.8
Ripërdorimi i pajisjeve tuaja	0		0		0		1	2.5 (- 4.0,9.1)	0.1	-

### Përdorimi i shiringës së mbushur paraprakisht në muajin e fundit

Në përgjithësi, rreth 42% e popullsisë të PDI-ve ka përdorur shiringë të pambushur në muajin e fundit me shifrën më të lartë të raportuar në Tiranë (48%) dhe më të ulët (15%) në Durrës (Grafiku 8).



**Grafiku 8. Përdorimi i një shiringë të pambushur në muajin e fundit sipas qyteteve**

Në përgjithësi, rreth 11% e popullatës të PDI-ve kanë injektuar drogë me një shiringë të mbushur më parë, të mbushur më pas, ose e kanë përdorur atë për të ndarë dozat e drogës në muajin e fundit (Tabela 12). Ky fenomen ishte më i përhapur në Tiranë (13%) dhe Berat (13%), më i ulët në Elbasan (8%) dhe shumë i ulët në Durrës (rreth 1%).

**Tabela 12. Parambushja, pasmbushja, ndarja e dozës në muajin e fundit**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej n=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Frekuenca e parambushjes, pasmbushjes dhe ndarjes së dozës në muajin e fundit</b>										
kurrë	182	59.4 (53.2,65.6)	109	73 (62.1,83.3)	64	44 (35.1,53.1)	113	75.5 (69.2,81.9)	59.6	47.3,72.0
Ndonjehere	82	27.5 (22.1,32.9)	39	26.4 (16.1,37.3)	73	47.7 (38.5,57.1)	17	11.6 (7.0, 16.0)	29.2	18.1,41.4
Pothuajse çdo herë	12	3.47 (1.5,5.4)	2	0,5 (0,1)	13	8.1 (4,12.1)	12	7.9 (4.1,11.6)	3.9	0,2,10,5
Gjithmon	29	9.6 (6.1,13.0)	0		0		8	4.9 (1.9,7.8)	7.4	2.3,17.8

#### 4.1.2.6 Shkëmbimi i pajisjeve të injektimit

##### 4.1.2.6.1 Shpeshtësia e shkëmbimit të pajisjeve të injektimit në muajin e fundit

Rreth 47% e popullatës së PDI kanë shkëmbyer pajisjet e injektimit çdo herë ose pothuajse çdo herë në muajin e fundit. Prevalenca e kësaj sjellje të rrezikshme ishte më lartë në Elbasan (77%) dhe më e ulët në Berat (24%). Rreth 49% e popullatës së PDI-ve ka marre drogë nga një enë e përbashkët e përbashkët çdo herë ose pothuajse çdo herë në muajin e fundit (Tabela 13). Ky fenomen është shumë më i përhapur në Elbasan (76%) dhe haset më pak në Berat (24 %).

**Tabela 1. Shpeshtësia e shkëmbimit të pajisjeve të injektimit në muajin e fundit**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej n=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>Shpeshtësia e shkëmbimit të pajisjeve të injektimit në muajin e fundit</b>										
Kurrë	103	33.2 (28.6,38.4)	47	35.6 (25.4,45.3)	9	5.8 (2,9.6)	95	63.9 (57.0,70.6)	31.4	21.1,42.7
Ndonjehere	65	23.1 (18.0, 28.3)	44	20.5 (13.5,27.4)	29	16.7 (11.3, 22.2)	19	12.2 (7.7,16.8)	21.8	14.5,33.7
Pothuajse çdo herë	67	22.6 (17.6,27.3)	27	12 (6.6,17.4)	107	72.8 (65.4,80.1)	27	18.2 (12.7, 23.6)	27.1	18.7,39.2
Gjithmonë	70	21.1 (16.6, 25.5)	32	31.9 (18.2,45.8)	5	4.5 (1,8)	9	5.6 (2.6,8.5)	19.7	10.3,31.8
<b>Shpeshtësia e marrjes së drogës nga një enë e përbashkët në 1 muajin e fundit (n=315)</b>										
Kurrë	96	31.1 (26.1,35.9)	38	24.8 (16.1,33.1)	10	6.5 (2.4, 10.6)	94	63.1 (56.6,69.7)	28.7	23.0,33.4
Ndonjehere	70	24.7 (19.5,30.0)	35	20.6 (12.6,28.6)	31	17.9 (11.7, 24.1)	20	12.9 (8.3, 17.6)	23.1	18.9,28.0
Pothuajse çdo herë	68	22.6 (17.5,27.5)	27	11.7 (6.4,16.8)	105	71.8 (64.2,79.4)	27	18.1 (12.7, 23.5)	26.9	22.0,32.4
Gjithmonë	71	21.6 (17.0, 26.3)	50	31.8,54.2)	4	3.6 (0,7.2)	9	5.7 (2.5,8.8)	21.2	16.6,30.4


Në përgjithësi, pothuajse e gjithë popullata e PDI-ve është në gjendje të sigurojë shiringa të reja, të papërdorura kur nevojitet dhe pothuajse çdo PDI njih një vend/person për këtë (Tabela 14).

**Tabela 14. Aftësia për të siguruar age/shiringa të reja, të papërdorura kur nevojiten dhe njohja e vendeve/personave ku mund të sigurohen**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej n=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95%
<b>Mund të siguri një shiringa të reja, të papërdorura kur është e nevojshme</b>										
	305	100	150	100	150	100	148	98.6 (97.0,99.9)	99.9	
<b>Një një person/vend mund të marrë shiringa të reja, të papërdorura</b>										
	305	100	150	100	150	100	148	98.6 (97.0,99.9)	99.9	
Mund të sigurojë age/shiringa të reja të papërdorura nga:										
Farmaci	297	97.4 (95.4,99.0)	147	99.4 (98.8,99.7)	148	98.8 (97.4,100.2)	147	99.3 (98.8,99.7)	98.5	98.2,99.7
Punonjës shëndetësor	0		3	1 (0.2,1.0)	0		0		0.1	-
Spital	4	1.3 (0.1,2.6)	6	1.6 (0.7, 2.5)	9	5.5 (2.2,8.8)	2	1.3 (-0.2, 2.9)	1.7	0.5,3.7
Punonjës outreach	267	87.5 (82.9,91.1)	103	60 (46.7,72.5)	47	32.6 (25.5,39.6)	84	56.9 (51.2,62.8)	78	75.7, 82.4
Familja/të afërmit	7	2.3 (2.0,4.3)	3	1.5 (0.4, 2.6)	0		0		1.8	0.5,3.3
Partneri seksual	2	0.7 (0.1,2)	0		0		0		0.3	-
Shokë	9	3.0 (1.0,4.9)	5	1.37 (0.3,2.3)	2	1.8 (0.1,3.8)	2	1.2 (0.1, 2.3)	3	0.8,6.8
Përdorues e tjerë të drogës	5	1.6 (0.1,3.3)	9	5.3 (1.2,9.5)	1	1.2 (0.4, 2.9)	1	0.6 (0.4,1.7)	2.1	0.7, 4.2
Shpërndarës droge	4	1.3 (0.3,3.0)	4	1.5 (0.2, 2.8)	2	0.8 (0.1,5.0)	0		1.3	0.2, 3.0
Program i shkëmbimit të shiringave	233	76.4 (71.5,81.3)	96	56.3 (44.9,67.7)	86	57.3 (48.6,65.9)	100	68.6 (62.8,74.5)	74.5	71.0,81.4
Vjedh	5	1.6 (0.3,3.5)	21	15.3 (7.7,22.8)	1	0.5 (0.3, 1.4)	4	2.2 (0.5, 3.9)	2.5	0.1,3.7
Ble në rrugë	1	0.3 (0.1,1.7)	0		1	0.5 (0.1,1.2)	0		0.5	-


Në përgjithësi, 99% e popullatës të PDI e dinë mund të sigurojnë age/shiringa të reja, të papërdorura në farmaci, 78% përmendën punonjës outreach dhe 75% programin e shkëmbimit të shiringave si burim për gjetjen e ageve/shiringave të reja, të papërdorura (Grafiku 9).





**Grafiku 9. Burimet ku mund të sigurohen age/ shiringa të reja, të papërdorura kur është e nevojshme**

Farmacia është burimi kryesor për sigurimin e ageve/shiringave të reja, të papërdorura në çdo vend studimi (të dhënat mungojnë për Durrësin), duke filluar nga 97% në Tiranë në 99% në Berat, Punonjësit outreach dhe programet e shkëmbimit të shiringave si burim i tillë përmenden respektivisht nga 88% dhe 76% e popullatës të PDI në Tiranë, shifra dukshëm më të larta krahasuar me përqindjet përkatëse që përmendin këto burime në qytetet e tjera e tjera ku u krye studimi (Grafiku 10).



**Grafiku 10. Burimet për sigurimin ageve/shiringave të reja, të papërdorura kur nevojiten, sipas qyteteve**

#### 4.1.2.7 . Trajtimi i drogës


Vlerësimet në popullatë tregojnë se rreth dy të pestat (40%) e të gjithë PDI-ve nuk kanë marrë kurrë ndonjë trajtim për varësinë e tyre ndaj drogës, ndërkohë që pothuajse gjysma e tyre janë aktualisht nën trajtim (Tabela 15). Përqindja e PDI-ve që nuk kanë marrë ndonjëherë trajtim për varësinë nga droga vështë shumë më i lartë në Berat (63%) dhe Elbasan (48%) krahasuar me të gjithë popullatën e PDI-ve, ndërsa në Durrës është mjaft i ulët (20%). Nga ana tjetër, dy të tretat e popullatës të PDI-ve (67%) në Durrës ishin nën trajtim në momentin e studimit, që është më e lartë se përqindja e e popullatës totale korresponduese, ndërsa në Berat vetëm 1/3 (29%) e PDI ishin aktualisht nën trajtim.

Rreth 5% e popullatës të PDI ishte e regjistruar në një qendër publike trajtimi për shkak të përdorimit të drogës në kohën e studimit, shifra më e lartë ishte në Durrës (15%) dhe më e ulët në Elbasan (4%), ndërsa nuk ka të dhëna për Tiranën (Tabela 15).

**Tabela 15. Në trajtim për shkak të përdorimit të drogës dhe lloji i trajtimit**

	Tirane N=305		Durrës N=150		Elbasan N=150		Berat N=150		Gjithsej n=755	
	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	N	%, (95% IB)	%	95% IB
<b>I janë nënshtruar trajtimit/kanë marrë ndihmë për shkak të përdorimit të drogës</b>										
Aktualisht po i nënshtrohet trajtimit ose merr ndihmë	155	49 (43.6,54.2)	112	66.6 (52.8,80.1)	66	45.3 (35.6,54.9)	43	29.3 (22.8,35.7)	49.7	40.4,51.6
Ishte, por nuk po merr më trajtim apo ndihmë	34	10.8 (7.5,14.1)	16	13.9 (5.4,22.4)	12	7.1 (3.4, 10.8)	10	7.4 (3.5, 11.3)	10.6	4.0,15.3
Nuk kanë marrë kurrë trajtim apo ndihmë	116	40.2 (34.8,45.6)	22	19.5 (8.7,30.3)	72	47.5 (37.5,57.6)	97	63.2 (56.7,69.7)	39.7	30.1,49.5
<b>Llojet e trajtimit dhe ndihmës së marrë (n=326)</b>										
Trajtim ambulator	11	4.6 (0.3,8.7)	45	32 (20.3,42.6)	0		2	3.9 (1.7,10.5)	7.9	5.2,11.6
Detoksifikim me metadon	7	3.5 (1.2,6.7)	14	9.2 (3,15.3)	1	1.2 (0.5,4.1)	0		3.9	2.2,6.8
Terapi mbajtëse me metadon	174	92.1 (88.5,95.8)	111	86.6 (76.4,96.7)	76	98 (94.2,99.8)	52	96.7 (90.8,98.8)	92.1	88.1,94.8
Terapi mbajtëse me buprenorfinë	11	5.0 (2.9,9.6)	14	8.7 (3.0,14.4)	2	2.3 (0.4, 7.0)	3	5.9 (2.3, 14.4)	6.3	3.8,10.1
Detoksifikimi me barna të tjera	7	3.8 (1.6,6.8)	11	6.4 (1.2, 11.5)	7	10.9 (1.6,20.5)	2	3.2 (1.7,8.2)	4.6	2.7,7.4
Detoksifikimi pa drogë	3	1.6 (0.1,3.4)	2	1.1 (0.3, 3.3)	0		2	3.4 (1.6,8.4)	1.4	0.4,3.9
Rehabilitim rezidencial	6	3.2 (1.1,5.8)	5	2 (0.1,4.2)	0		3	5.3 (1.9,12.5)	2.4	1.1,5.1
Ndihmuar/detyruar të linte menjëherë	1	0.2 (0.1,1.6)	12	9.7 (2.1,17.2)	0		2	5.0 (2.9,14.2)	2.2	0.7,5.0
<b>I regjistruar qendër publike trajtimi për shkak të përdorimit të drogës</b>										
			11	14.7 (5.9,23.5)	2	4.0 (3.0, 11.2)	5.7	2.3,11.7	5.2	2.1,12.3


